- C) Qendra Kombëtare e Kinematografisë
- D) Universiteti i Arteve

Pyetja 58

Çfarë quhet film Independent (i pavarur)?

- A) Film i financuar nga studiot ose institucionet shtetërore
- B) Film dokumentar
- C) Film pa kufizime krijuese e zakonisht buxhet të ulët
- D) Film i xhiruar me 35mm

Pyetja 59

Cili nga regjisorët shqiptarë nuk ka qënë pedagog në Universitetin e Arteve, Tiranë?

- A) Kristaq Mitro
- B) Besnik Bisha
- C) Mevlan Shanaj
- D) Viktor Gjika

Pyetja 60

Kush nga filmat e ka trajtuar temën e Kanunit?

- A) 'The Albanian Virgin'
- B) 'Open Doors'
- C) 'A Cup of Coffee and new Shoes on'
- D) 'Nji prej Nesh'

Pyetja 61

Çfarë do të thotë DSLR?

- A) Digital Single Light Reflex
- B) Digital Single Lens Reflex
- C) Digital Single Lens Refract
- D) Digital Single Light Remote

Pyetja 62

Cili nga proceset më poshtë përshkruan më saktë camera obscura (dhoma e errët)?

- A) Rrezet e dritës përthyhen dhe fokusohen nga lentet në një sipërfaqe të ndjeshme ndaj dritës
- B) Rrezet hynë nga një vrimë rrethore në një kuti të izoluar nga drita duke projektuar një imazh kokëposhtë të subjektit
- C) Një pasqyrë reflekton dritën në një sipërfaqe me material të ndjeshëm ndaj dritës
- D) Drita thithet nga një sensor dixhital dhe konvertohet në sinjal elektrik për të krijuar një imazh

Pyetja 63

Cili ishte subjekti i fotografisë së parë të realizuar nga Joseph Nicéphore Niépce në 1827?

- A) Portreti I familjes së Niépce
- B) Oborri i shtëpisë së Niépce
- C) Një bulevard në Paris
- D) Një vazo me lule

Pyetja 64

Cili parametër e përshkruan sasinë e dritës që shkon në sensor?

- A) ISO
- B) Diafragma
- C) Ekspozimi
- D) Perdja e sensorit

Pyetja 65

Çfarë kontrollon diafragma?

- A) Ndjeshmërinë e sensorit
- B) Sasinë e dritës që hyn në kamera
- C) Kohën që rri hapur perdja e sensorit
- D) Rezolucionin e imazhit

Pyetja 66

Cila ISO do ishte më e përshtatshme për ambjentet me pak dritë?

- A) ISO 200
- B) ISO 400
- C) ISO 800
- D) ISO 1600

Pyetja 67

Si quhet distanca mes objektit më të afërt dhe më të largët që konsiderohet në fokus?

- A) Thellësi fushe
- B) Thellësi fokale
- C) Fushë veshtrimi
- D) Distanca hiperfokale

Pyetja 68

Çfarë kuptoni me fjalën 'bokeh' në fotografi ?

- A) Qartësinë e subjektit kryesor
- B) Cilësinë e zonave të çfokusuara të imazhit
- C) Kontrastin mes sipërfaqeve të errëta dhe të shndritshme
- D) Këndin e objektivit

Pyetja 69

Cili është qëllimi i vendosjes së filtrit neutral density (asnjanës) përpara objektivit?

- A) Të zbusë dridhjen e aparatit
- B) Të rrisë ndjeshmërinë e sensorit
- C) Të zbusë reflektimet
- D) Të ulë sasinë e dritës në aparat

Pyetja 70

Cili është efekti i përdorimit të kohës së gjatë të ekspozimit?

- A) Të ngrijë lëvizjen
- B) Të rrisë zhurmën dixhitale
- C) Ti japë dritë imazhit
- D) Të krijojë iluzionin e lëvizjes

Pyetja 71

Cili komponent i aparatit e thith dritën dhe e konverton atë në imazh dixhital?

- A) Objektivit
- B) Perdja e sensorit
- C) Sensori
- D) Vizori

Pyetja 72

Çfarë përcakton distanca fokale e një objektivit?

- A) Përmasën e diafragmës
- B) Zmadhimin dhe këndin e vështrimit

- C) Ndjeshmërinë
- D) Kohën e ekspozimit

Pyetja 73

Cili nga objektivët e mëposhtëm konsiderohet i përshtatshëm për portret?

- A) 16mm
- B) 35mm
- C) 50mm
- D) 85mm

Pyetja 74

Çfarë kuptoni me fjalën 'HDR' në fotografi?

- A) High Definition Range
- B) High Dynamic Range
- C) High Depth Resolution
- D) High Density Reflection

Pyetja 75

Çfarë konsiderohet si zhurmë në fotografiminë dixhitale?

- A) 'Kokrriza' të padëshiruara ne zonat e hijes kryesisht
- B) Sasi e tepërt e dritës në fotografi
- C) Mungesa e mprehtësisë në fotografi
- D) Devijime të padëshiruara të ngjyrës

Pyetja 76

Cili nga programet e fotografimit të lejon të vendosësh vetë kohë e ekspozimit dhe diafragmën?

- A) Auto
- B) Aperture Priority
- C) Shutter Priority
- D) Manual

Pyetja 77

Çfarë është 'rregulla e treshit' në fotografi?

- A) Princip për të vendosur balancen e bardhë
- B) Sugjerim për të kompozuar imazhin
- C) Teknikë për të korrigjuar ekspozimin
- D) Metodë për të fokusuar

Pyetja 78

Cili nga elementët më poshtë përdoret për të kontrolluar thellësinë e fushës?

- A) Shutter speed
- B) ISO
- C) Diafragma
- D) Distanca fokale

Pyetja 79

Si quhen objektivet që ndryshojnë distancën fokale?

- A) Lente fikse
- B) Lente bifokale
- C) Lente zoom
- D) Lente telefoto

Pyetja 80

Cila do ishte koha më e përshtatshme e ekspozimit për të ngrirë një subjekt në lëvizje?

- A) 1/15s
- B) 1/60s
- C) 1/125s
- D) 1/500s

## **Kapitulli 5. Faza përgatitore e xhirimit dhe organizimi i sheshxhirimit**

Pyetja 1

Cili është qëllimi i fazës përgatitore(preproduction) të xhirimit?

- A) Fillimi i xhirimit
- B) Montazhi
- C) Planifikimi dhe organizimi i filmit
- D) Marketingu

Pyetja 2

Cili është përgjegjës për krijimin e skenarit?

- A) Regjisori
- B) Producenti
- C) Drejtori i fotografisë
- D) Skenaristi

Pyetja 3

Cili dokument përcakton elementët vizualë të çdo skene të filmit?

- A) Skenari
- B) Storyboard
- C) Call sheet
- D) Production report

Pyetja 4

Cila është detyra e regjisorit të casting gjatë fazës përgatitore?

- A) Xhirimi i skenave dytësore
- B) Gjetja e vëndeve të xhirimit
- C) Zgjedhja e aktorëve
- D) Montazhi i filmit

Pyetja 5

Kush merret me gjetjen e vëndeve të xhirimit?

- A) Casting director
- B) Regjisor
- C) Location manager
- D) Producenti

Pyetja 6

Për çfarë përdoret buxheti gjatë fazës përgatitore?

- A) Montazhin e filmit
- B) Organizimi i skenarit
- C) Menaxhimi i burimeve financiare
- D) Dizenjo e kostumeve

Pyetja 7

Kush është përgjegjës për aspektin financiar dhe administrativ të filmit?

- A) Producenti
- B) Skenaristi
- C) Aktori protagonist
- D) Regjisor

Pyetja 8

Cili është qëllimi i call sheet në fazën përgatitore?

- A) Te dizenjojë kostumet
- B) Te redaktojë skenarin
- C) Te gjejë vëndet e xhirimit
- D) Te organizojë ditët e xhirit

Pyetja 9

Si quhet përmbledhja e skenarit përpara se të shkruhet i plotë?

- A) Varianti final
- B) Skenari tekniko regjisorial
- C) Skenari letrar
- D) Treatment

Pyetja 10

Kush është përgjegjës për ndërtimin/dekorimin e vëndeve të xhirimit?

- A) Regjisori
- B) Producenti
- C) Skenografi
- D) Montazhieri

Pyetja 11

Çfarë quhet run through (lexim i plotë) i skenarit?

- A) Takimi i stafit për të diskutuar buxhetin
- B) Provë me aktorët ku lexohet i gjithë skenari
- C) Procesi i redaktimit të skenarit
- D) Metodë për të vizatuar storyboard

Pyetja 12

Cili dokument zbërthen skenarin në elementë të produksionit?

- A) Storyboard
- B) Script breakdown
- C) Call sheet
- D) Shot list (lista e planeve)

Pyetja 13

Kush është përgjegjës për krijimin e 'call sheet'?

- A) Regjisori
- B) Producenti

- C) Asistenti i parë i regjisë
- D) Asistenti i parë i kamerës

Pyetja 14

Cili është roli i drejtorit të fotografisë dhe skenografit gjatë fazës përgatitore?

- A) Proçesi i casting
- B) Krijimi i stilit vizual të filmit
- C) Shkrimi i skenarit
- D) Vizatimi i storyboards

Pyetja 15

Cili është qëllimi i stafit të produksionit?

- A) Të montojë filmin
- B) Të bëjë prova me aktorët
- C) Të testojë paisjet
- D) Të planifikojë ditët dhe kohën e xhirimit

Pyetja 16

Çfarë është shot list (lista e planeve)?

- A) Një listë e të gjithë skenave të filmit
- B) Një listë e planeve të planifikuara për çdo skenë
- C) Një listë e aktorëve në film
- D) Një listë e vëndeve të xhirimit

Pyetja 17

Cili është detyra kryesore e producentit

- A) Të finalizojë skenarin
- B) Të xhirojë skenat
- C) Të sigurojë financimin e filmit
- D) Të montojë materialin

Pyetja 18

Cili është përfaqësuesi i montazhierit në shesh xhirimi?

- A) Producenti
- B) Script supervisor
- C) Drejtori i fotografisë
- D) Regjisori

Pyetja 19

Cili është roli i unit production manager(UPM) në produksion?

- A) Të sigurojë që buxheti i filmit nuk kalohet
- B) Të sinkronizojë materialet
- C) Të transportojë ekipin
- D) Të finalizojë skenarin

Pyetja 20

Kush i përcakton rregulloret e kohëzgjatjes dhe pagesave të stafit të xhirimit ?

- A) Individët e punësuar
- B) Producenti
- C) Sindikatat ose shteti
- D) Regjisori

Pyetja 21

Kush është përgjegjës për aspektin fotografik të filmit?

- A) Drejtori i fotografisë
- B) Skenografi
- C) Regjisori
- D) Montazhieri

Pyetja 22

Si quhet në shqip vendi ku xhirohet një film ?

- A) Skenë
- B) Studio
- C) Lokacion
- D) Shesh xhirimi

Pyetja 23

Kush është përgjegjës për xhirimin e filmit brenda afatit kohor të përcaktuar nga produksioni?

- A) Menaxheri i produksionit
- B) Shefi i ndriçimit
- C) Asistent regjisori
- D) Regjisori

Pyetja 24

Cili është funksioni i çakut në shesh xhirimi ?

- A) Të organizojë skenarin
- B) Të ndihmojë aktorët
- C) Të sinkronizojë audion me videon
- D) Të ndriçojë skenografinë

Pyetja 25

Kush është përgjegjës për krijimin dhe administrimin e buxheti të filmit?

- A) Skenaristi
- B) Drejtori i Fotografisë
- C) Producenti
- D) Regjisori

Pyetja 26

Çfarë do të thotë 'blocking' për kamerën?

- A) Montazhi i skenave
- B) Koreografia e aktorëve dhe kamerës
- C) Dizajni i dekorit
- D) Ndriçimi i dekorit

Pyetja 27

Kush është përgjegjës për ruajtjen e vazhdimësisë gjatë xhirimit?

- A) Grimieri
- B) Operatori i zërit
- C) Montazhieri
- D) Script supervisor

Pyetja 28

Cili është roli kryesor i shefit të ndriçimit në film?

- A) Operimi i kamerës
- B) Administrimi i ekipit të xhirimit
- C) Konceptimi dhe zbatimi i planit të ndriçimit
- D) Drejtimi i aktorëve

Pyetja 29

Kush është përgjegjës për ekzekutimin e kompozimit të planit?

- A) Operatori i kamerës

- B) Drejtori i Fotografisë
- C) Regjisori
- D) Kostumografi

Pyetja 30

Çfarë do të thotë 'rolling' në shesh xhirimi?

- A) Fillimi i skenës së re
- B) Fundi i ditës së xhirimit
- C) Përgatitja e paisjeve
- D) Regjistrimi i imazhit ose i zërit

Pyetja 31

Kush është përgjegjës për regjistrimin e zërit gjatë xhirimit?

- A) Dizenjuesi i zërit
- B) Miksuesi i zërit
- C) Kompozitori
- D) Montazhieri

Pyetja 32

Kush është përgjegjës për makiazhin e aktorëve para kamerës?

- A) Kostumografi
- B) Grimieri
- C) Skenografi
- D) Regjisori

Pyetja 33

Çfarë përgjegjësie ka scenografi?

- A) Te krijojë ambientin fizik të filmit
- B) Te supervizojë montazhin
- C) Të ndjekë procesin e ndriçimit
- D) Të transportojë ekipin

Pyetja 34

Cili është standarti për kohëzgjatjen e ditës së xhirimit?

- A) 8 orë
- B) 10 orë
- C) 12 orë

D) 14 orë

Pyetja 35

Kush thërret action (aksion) për fillimin e planit?

- A) Producenti
- B) Asistenti i regjisë
- C) Operatori
- D) Regjisori

Pyetja 36

Çfarë do të thotë dubël?

- A) Provë me aktorin
- B) Kontrolli i planit në monitor
- C) 'Rec start' deri në 'rec stop' të kamerës
- D) Skena e përfunduar

Pyetja 37

Çfarë tregon 'call time' ne dokumentin ditor(call sheet)?

- A) Kohën kur duhet të vish në sheshin e xhirimit
- B) Kohën kur duhet të jetë gati grimi
- C) Kohën kur xhirohet plani i parë
- D) Kohën kur stafi duhet të jetë gati për xhirim

Pyetja 38

Çfarë është 'call sheet'?

- A) Lista e stafit
- B) Programi ditor i xhirimit
- C) Përmbledhje e skenarit
- D) Raporti i buxhetit

Pyetja 39

Kush është përgjegjës për përgatitjen e listës së planeve të ditës së xhirimit?

- A) Kostumografi
- B) Drejtori i Fotografisë
- C) Producenti
- D) Regjisori

Pyetja 40

Nëse në përfundimin të orarit të xhirimit kanë mbetur disa plane pa u xhiruar, si duhet të veprohet ?

- A) Vazhdohet xhirimi derisa xhirohet gjithshka
- B) Ndërpritet xhirimi
- C) I merret leje stafit për të vazhduar kundrejt pagesës shtesë
- D) Vendos producenti

Pyetja 41

Cili është përgjegjës për drejtimin e aktorëve në sheshin e xhirimit?

- A) Producenti
- B) Skenaristi
- C) Regjisori
- D) Montazhieri

Pyetja 42

Cila është teknika që regjisorët përdorin për të ndihmuar aktorët të zbërthejnë motivimin e personazhit në një skenë?

- A) Improvizimi
- B) Storyboard
- C) Mësimi i tekstit
- D) Analizë e rrugëtimit të personazhit

Pyetja 43

Si quhet procesi i zgjedhjes së aktorit për një rol?

- A) Casting
- B) Kërkimi i vëndeve të xhirimit
- C) Faza përgatitore
- D) Xhirimi

Pyetja 44

Cili nga regjisorët është i njohur për dubla të shumta me aktorët?

- A) Alfred Hitchcock
- B) Stanley Kubrick
- C) Woody Allen
- D) Peter Jackson

Pyetja 45

Si quhet procesi i përcaktimit të lëvizjes dhe pozicionit të aktorëve në shesh xhirimi?

- A) Blocking
- B) Editing
- C) Dubbing
- D) Casting

Pyetja 46

Si komunikon regjisori me aktorët në shesh xhirim?

- A) Nëpërmjet monitorit
- B) Nëpërmjet kufjeve
- C) Nëpërmjet asistentit
- D) Komunikim i afërt

Pyetja 47

Cili regjisor ka punuar më shpesh dhe merr performanca superiore nga Robert De Niro dhe Leonardo DiCaprio?

- A) George Lucas
- B) Ridley Scott
- C) Tim Burton
- D) Martin Scorsese

Pyetja 48

Cili është qëllimi kryesor i regjisorit në punën me aktorët?

- A) Të sigurojë që aktorët të ndjekin skenarin
- B) Të prodhojë performanca të besueshme dhe origjinale
- C) Të qëndrojë brënda buxhetit të filmit
- D) Të menaxhojë efektet speciale

Pyetja 49

Cili aktor ka fituar emimin Oskar për filmin 'There will be Blood'?

- A) Al Paçino
- B) Daniel Day-Leëis
- C) Kevin Costner
- D) Alec Baldwin

Pyetja 50

Cili është roli i regjisorit në zhvillimin e karakterit të personazhit?

- A) Shkrimi i skenarit
- B) Përcaktimi i kostumeve
- C) Drejtimi i interpretimit të aktorit
- D) Operimi i kamerës

Pyetja 51

Çfarë është karakteristikë e method acting?

- A) Përdorimi i gjesteve dhe mimikës të ekzagjeruar
- B) Memorizimi i tekstit pa interpretim emocional
- C) Të bazohesh në eksperiencat personale për krijimin e personazhit
- D) Të mbështetesh vetëm në udhëzimet e regjisorit

Pyetja 52

Cila është metoda që regjisori përdor për ta mbajtur aktorin brënda karakterit mes planeve?

- A) I kërkon të rilexojë skenarin
- B) I mban të izoluar nga ekipi
- C) I inkurajon të qëndrojnë në karakter edhe kur nuk xhirojnë
- D) I mundëson pauza të shpeshta

Pyetja 53

Cila është procesi që zgjat më shumë në shesh xhirim?

- A) Provat me aktorët
- B) Memorizimi i tekstit
- C) Procesi i ndriçimit
- D) Përsëritja për kamerën

Pyetja 54

Cili regjisor ka punuar më shumë me aktorin Johnny Depp?

- A) Tim Burton
- B) James Cameron
- C) Tony Scott
- D) Steven Spielberg

Pyetja 55

Si e ndihmon regjisori aktorin në skenat emocionale?

- A) Duke i dhënë udhëzime ne cdo dubël
- B) Duke krijuar nje sheshxhirim të qetë dhe pa stres
- C) Duke krijuar humor
- D) Duke u fokusuar në pjesën teknike

Pyetja 56

Cili regjisor është unik në krijimin e një bote vizuale surreale në shumicën e filmave të tij?

- A) Wes Anderson
- B) David Lynch
- C) Joel Coen
- D) Michael Bay

Pyetja 57

Si mundet një regjisor të krijojë besim te aktori?

- A) Duke i dhënë lirshmëri në interpretim
- B) Duke i lavdëruar vazhdimisht
- C) Duke komunikuar dhe bashkëpunuar haptazi
- D) Duke u fokusuar në pjesën teknike

Pyetja 58

Cili regjisor është i fiksuar pas detajeve dhe vizionit, i shquar për perfeksionin vizual?

- A) Peter Jackson
- B) Kathryn Bigelow
- C) Martin Scorsese
- D) David Fincher

Pyetja 59

Cili term përdoret kur regjisori dhe aktori diskutojnë biografinë dhe motivimet e personazhit?

- A) Lexim teksti
- B) Provë
- C) Analizë e personazhit
- D) Vendosje për kamerën

Pyetja 60

Cila nga teknikat e aktrimit kërkon përdorimin e emocioneve dhe eksperiencave personale të aktorit për të krijuar botën e personazhit?

- A) Teknika e Meisner
- B) Aktrimi klasik
- C) Method Acting
- D) Teknika e Chekhov

## **Kapitulli 6 Estetika e filmit**

Pyetja 1

Çfarë fjale përdoret për organizimin e elementëve brenda kuadrit?

- A) Mizanskenë
- B) Montazh
- C) Vazhdimësi
- D) Kërcitje(Jump Cut)

Pyetja 2

Cili element i estetikës së filmit përdor ngjyrën dhe ndriçimin?

- A) Imazhi
- B) Montazhi
- C) Dizajni i zërit
- D) Skenari

Pyetja 3

Cili është qëllimi kryesor i muzikës në film?

- A) Të ndihmojë elementët vizualë
- B) Të qartësojë dialogun
- C) Të mbështesë narracionin (rrëfimin) dhe zbulojë emocion
- D) Të krijojë atmosferën e ambientit

Pyetja 4

Cila fjalë përshkruan kalimin nga një plan në tjetrin?

- A) Panoranim horizontal
- B) Zoom
- C) Panoranim vertikal

D) Prerje

Pyetja 5

Cili është roli i 'CGI' në film?

- A) Të montojë filmin
- B) Të shkruajë skenarin
- C) Të gjenerojë imazhe në kompjuter
- D) Të drejtojë aktorët

Pyetja 6

Cilat fjalë më poshtë përshkruajnë përdorimin e dritës dhe hijeve për të krijuar atmosferën?

- A) Chiaroscuro
- B) Verisimilitude
- C) Diegesis
- D) Kinetoscope

Pyetja 7

Çfarë kuptoni me fjalën 'foley' në dizajnin e zërit?

- A) Zëri i ambjentit
- B) Zëri surround
- C) Efekte të zërit të krijuara live në post produksion
- D) Zëri i sfondit

Pyetja 8

Si quhet teknika e vendosjes së objekteve në planin e parë, të dytë dhe sfond, për të krijuar thellësi në kuadër?

- A) Deep focus
- B) Cross-cutting
- C) Parallel editing
- D) Match cut

Pyetja 9

Çfarë është 'Dutch angle'?

- A) Plan ku kamera është e anuar për të krijuar një ndjesi shqetësimi
- B) Plan i marrë nga sipër subjektit
- C) Plan që ndjek një personazh
- D) Plan që kompozon subjektin në qendër

Pyetja 10

Çfarë e përfaqëson gjuhën vizuale të filmit 'noir'?

- A) Ngjyra të shndritshme dhe të saturuara
- B) Përdorim i efekteve speciale
- C) Ndriçim me regjim të lartë të dritës
- D) Ndriçim me regjim të ulët të dritës

Pyetja 11

Çfarë është termi 'montage' ne montazhin e filmit?

- A) Teknika e përdorimit të planeve të gjata
- B) Sinkronizimi i zërit dhe imazhit
- C) Sekuenca e planeve që tregojnë kalimin e kohës dhe ndërtojnë narracionin (rrëfimin)
- D) Arranzhimi i skenave në rrjedhë lineare

Pyetja 12

Cila fjalë i referohet shpejtësisë së zhvillimit të narracionit (rrëfimit)?

- A) Ritëm
- B) Perceptim
- C) Atmosferë
- D) Stil

Pyetja 13

Çfarë është kompozimi ne film?

- A) Përdorimi i zërit në film
- B) Aranzhimi i elementëve brënda kuadrit
- C) Montazhi i narracionit (rrëfimit)
- D) Dizajni i sheshxhirimit

Pyetja 14

Cila fjalë përshkruan teknikën vizuale që e bën më të vërtetë një skenë/film?

- A) Realizëm
- B) Formalizëm
- C) Ekspresionizëm
- D) Surrealizëm

Pyetja 15

Cili është qëllimi i përdorimit të portretit në film?

- A) Të tregojë gjeografinë
- B) Të krijojë një sens distancimi
- C) Te theksojë detajin ose emocionin e aktorit
- D) Të prezantojë një personazh të ri

Pyetja 16

Ç'do të thotë 'cross-cutting' në montazhin e filmit

- A) Të presësh nga një plan te tjetri në të njëjtin vënd
- B) Të presësh mes dy ose më shumë skenash që ndodhin njëkohësisht
- C) Të eliminosh pjesë të panevojshme të skenës
- D) Të kalosh në një skenë tjetër pa lidhje me skenën aktuale

Pyetja 17

Çfarë e karakterizon një objektiv këndgjërë?

- A) Kompreson distancën mes objekteve
- B) Ka një kënd të ngushtë vështrimi
- C) Përdoret për portretin
- D) Deformon linjat pranë qoshes së kuadrit

Pyetja 18

Vizualisht, cili është qëllimi i skenës hapëse të një filmi?

- A) Të përcaktojë atmosferën
- B) Të prezantojë antagonistin
- C) Të zbulojë informacion
- D) Të përmbledhë narracionin (rrëfimin)

Pyetja 19

Cila teknikë montazhi përdor prerje për të krijuar vazhdimësinë e lëvizjes?

- A) Kërcitja
- B) Përputhja e aksionit
- C) Shkrirja
- D) Shkrirja në të zezë

Pyetja 20

Çfarë është 'aspect ratio' ne film?

- A) Raporti mes gjërësisë dhe lartësisë të fotogramës

- B) Kohëzgjatja e filmit
- C) Sasia e dritës që hyn në film
- D) Sasia e desaturimit të ngjyrës

Pyetja 21

Si quhet lidhja vizuale midis elementeve në një dizajn?

- A) Balancë
- B) Unitet
- C) Proporcion
- D) Ritëm

Pyetja 22

Si quhet organizimi i një kompozimi?

- A) Balancë
- B) Logo
- C) Dizajn
- D) Motiv

Pyetja 23

Si quhet shpërndarja e peshës vizuale brënda nje kompozimi?

- A) Ritëm
- B) Balancë
- C) Proporcion
- D) Teksturë

Pyetja 24

Si quhet vëndi ku bashkohen linjat e perspektivës në kompozim?

- A) Qëndër interesi
- B) Vatër
- C) Peshë vizuale
- D) Hapësirë boshe

Pyetja 25

Çfarë është një element vizual që përsëritet?

- A) Linjë
- B) Shkallë
- C) Motiv
- D) Unitet

Pyetja 26

Si quhet një rrymë e artit që trajton botën e ëndrrave dhe subkoshiencës?

- A) Barok
- B) Impresionizëm
- C) Surrealizëm
- D) Kubizëm

Pyetja 27

Cfare quhet qëndër interesi në një kompozim?

- A) Përsëritja e nje elementi
- B) Balanca vizuale
- C) Pikat e perspektivës
- D) Vëndi që tërheq syrin

Pyetja 28

Si quhet përmasa relative me një standart ose etalon ?

- A) Shkallë
- B) Unitet
- C) Ritëm
- D) Balancë

Pyetja 29

Si quhet niveli i dritës ose hijes së një ngjyre në bardhë e zi?

- A) Motiv
- B) Shkallë
- C) Formë
- D) Vlerë tonale

Pyetja 30

Si quhet shenja që lë një pikë në lëvizje?

- A) Vlerë
- B) Ritëm
- C) Proporcion
- D) Linjë

Pyetja 31

Si quhet emri ose simboli i dizenuar për tu njohur lehtë dhe saktë?

- A) Formë
- B) Teksturë
- C) Logo
- D) Motiv

Pyetja 32

Cili nga çiftet e ngjyrave në sistemin RGB, quhen komplementare?

- A) E bardhë – e Zezë
- B) E Kuqe – e Verdhë
- C) Jeshile – e Purpurt
- D) Portokalli – Blu

Pyetja 33

Punët e cilit piktor shpeshherë kineastët iu referohen për ndriçimin në film?

- A) El Greco
- B) Manet
- C) Rembrandt
- D) Delacroix

Pyetja 34

Çfarë është karakteristikë e rrymës Impresioniste?

- A) Paraqitja e dritës dhe veçorive të saj
- B) Paraqitja e thjeshtuar e subjektit
- C) Paraqitja e kontrasteve të forta të ngjyrës
- D) Paraqitja e temave epike

Pyetja 35

Cili nga artet e mëposhtme është tredimensional?

- A) Kinematografia
- B) Piktura
- C) Skulptura
- D) Fotografia

Pyetja 36

E cilit piktor është vepra e quajtur 'Vajza me vëth perle'?

- A) John Constable
- B) J.M.W. Turner
- C) Raffaello Sanzio da Urbino
- D) Johannes Vermeer

Pyetja 37

Kush nga piktorët e Rilindjes përdori nga të parët camera obscura (dhoma e errët) për detajet dhe portretet?

- A) Leonardo Da Vinci
- B) Jan Van Eyck
- C) Andrea Mantegna
- D) Sandro Botticelli

Pyetja 38

I cilësuar si një nga impresionistët e parë shqiptarë, cili ishte subjekti i preferuar i piktorit Vangjush Mio?

- A) Fëmijët
- B) Portreti
- C) Peisazhi
- D) Natyra e vdekur

Pyetja 39

Kush është piktori shqiptar, me të cilin krenohemi në botë, i influencuar nga kubizmi ?

- A) Kolë Idromeno
- B) Ibrahim Kodra
- C) Sadik Kaceli
- D) Abdurrahim Buza

Pyetja 40

Në cilin vit është vendosur monumenti i Skënderbeut, në qendër të Tiranës?

- A) 1955
- B) 1968
- C) 1990
- D) 2000

Pyetja 41

Cila është detyra kryesore e drejtorit të fotografisë(director of photography)?

- A) Të operojë kamerën
- B) Të drejtojë aktorët
- C) Të shkruajë skenarin
- D) Të mbajë përgjegjësi për fotografimin e filmit

Pyetja 42

Çfarë kuptoni me fjalën thellësi fushe(depth of field)?

- A) Distancën mes kamerës dhe subjektit
- B) Distancën mes objektit më të afërt dhe të largët në fokus
- C) Lartësinë e kamerës nga toka
- D) Fushën e vështrimit të një objektivi

Pyetja 43

Në cilin vit u nxorr patenta e kamerës së parë nga W.K.L. Dickson dhe Thomas Edison?

- A) 1880
- B) 1885
- C) 1891
- D) 1895

Pyetja 44

Cila nga lëvizjet e kamerës përfshin zhvendosjen e saj në hapësirë?

- A) Panoramimi vertikal(Tilt)
- B) Zoom(Zoom)
- C) Panoramimi horizontal(Pan)
- D) Karrel(Dolly)

Pyetja 45

Cili është qëllimi i planit 'tracking shot'?

- A) Të zmadhojë elementët brenda kuadrit
- B) Të ndjekë një subjekt në lëvizje
- C) Të panoramojë horizontalisht
- D) Të tregojë gjeografinë

Pyetja 46

Çfarë kuptoni me fjalën granë të filmit?

- A) Një lloj filmi(film stock) i caktuar
- B) Teknikë ekspozimi
- C) Teksturë vizuale që resulton nga ekspozimi e përpunimi në laborator
- D) Mënyrë për ndriçimin e skenës

Pyetja 47

Çfarë kuptoni me fjalën coverage (mbulim)?

- A) Organizimi i çdo elementi brenda kuadrit
- B) Dizajni i zërit
- C) Varianti i parë i montazhit
- D) Copëzimi i aksionit në plane të afërta

Pyetja 48

Cili objektiv përdoret për të pasur thellësi të vogël fushe?

- A) Objektiv kendngushtë
- B) Objektiv fisheye
- C) Objektiv makro
- D) Objektiv këndgjërë

Pyetja 49

Çfarë kuptoni me fjalën 'f-stop'?

- A) Kohën e ekspozimit
- B) Përmasën e diafragmës
- C) Ndjeshmërinë
- D) Distancën fokale

Pyetja 50

Çfarë përcakton përmasa në mm e objektivit, psh objektiv 25mm?

- A) Gjatësinë e objektivit
- B) Distancën minimale të fokusit
- C) Distancën mes lenteve
- D) Fushën dhe këndin e vështrimit

Pyetja 51

Çfarë konsiderohet një plan sekuencë?

- A) Një plan i xhiruar me objektiv normal
- B) Një plan i pandërprerë i të gjithë skenës
- C) Një plan i xhiruar nga një kënd i ulët
- D) Një plan i xhiruar me objektiv këndgjërë

Pyetja 52

Cila është arsyeja kryesore e zgjedhjes së një objektivit?

- A) Riprodhimi unik i perspektivës
- B) Zmadhimi ose zvogëlimi i objekteve në kuadër
- C) Format i sensorit
- D) Thellësia e fushës

Pyetja 53

Si quhet një nga dokumentarët më modernë në montazh dhe xhirim, i fillimit të shekullit të kalua, nga Dziga Vertov?

- A) 'Nanook of the North'
- B) 'Triumph of the Will'
- C) 'Man with a Movie Camera'
- D) 'Moana'

Pyetja 54

Cili është qëllimi i planit dhe kondraplanit mbi shpatull(OTS)?

- A) Të tregojë këndvështrimin e një personazhi
- B) Të tregojë marrëdhënien në hapësirë të dy personazheve
- C) Të paraqesë një vënd të ri xhirimi
- D) Të tregojë gjeografinë e një vëndi

Pyetja 55

Çfarë përcakton ndjeshmëria(ISO) e sensorit në kamerat dixhitale?

- A) Përmasën e sensorit të kamerës
- B) Ndjeshmërinë ndaj dritës të sensorit
- C) Diafragmën e objektivit
- D) Distancën fokale të objektivit

Pyetja 56

Çfarë përcakton plani portret (close up)?

- A) Përfshin sipërfaqe të madhe të sfondit
- B) Përfshin një copëz të sipërfaqes ose bustin e personazhit
- C) Përfshin një plan nga droni
- D) Përfshin një plan i të gjithë trupit të personazhti

Pyetja 57

Çfarë përcakton 'frame rate'?

- A) Numrin e fotogramave të ekspozuara në 1 sekondë
- B) Rezolucionin e videos
- C) Përmasën e sensorit
- D) Llojin e objektivit të përdorur

Pyetja 58

Sa është 'aspect ratio' i high definition ?

- A) 1.85:1
- B) 1.78:1(16:9)
- C) 2.40:1
- D) 1.66:1

Pyetja 59

Çfarë plani e përcakton vëndin ku ndodh ngjarja?

- A) Plani portret
- B) Plani i mesëm
- C) Plani i përgjithshëm
- D) Plani mbi shpatull(OTS)

Pyetja 60

Cili është qëllimi i teknikës 'dolly-zoom'(zoom në drejtim të kundërt me karrelin)?

- A) Të ndjekë një subjekt në lëvizje
- B) Të panoramojë një objekt të shpejtë

- C) Të zbulojë informacion shtesë
- D) Të krijojë një efekt ç'orientues

Pyetja 61

Cili është roli kryesor i montazhierit?

- A) Sinkronizimi i materialit
- B) Dublimi i zërit
- C) Krijimi i variantit final të filmit
- D) Kurimi i efekteve speciale

Pyetja 62

Çfarë është efekti 'jump cut' në montazh?

- A) Ta bëjë të padukshme prerjen
- B) Të ruajë vazhdimësinë
- C) Të eliminojë material të panevojshëm
- D) Të ndërpresë vazhdimësinë duke krijuar ç'orientim

Pyetja 63

Cili regjisor rus e përdori montazhin për të influencuar politikisht njerëzit?

- A) Sergei Eisenstein
- B) Andrei Tarkovsky
- C) Mikhail Kalatozov
- D) Aleksandr Sokurov

Pyetja 64

Cili është qëllimi kryesor i montazhit në filmat narrativë?

- A) Ta bëjë të padukshme prerjen
- B) Të shtojë efekte speciale
- C) Të krijojë montazh paralel
- D) Të krijojë tension

Pyetja 65

Çfarë është 'match cut'?

- A) Tranzicion mes skenave
- B) Lëvizje e caktuar e kamerës
- C) Prerje që krijon një lidhje vizuale mes dy planeve
- D) Prerje që eliminon dialogun

Pyetja 66

Cili është qëllimi i 'color grading' në post production?

- A) Të krijojë atmosferën dhe besueshmërinë e imazhit
- B) Të montojë skenat me dialog
- C) Të shtojë zërin e ambjentit
- D) Të miksojë pistat e zërit

Pyetja 67

Cili është një princip i montimit të videoklipit?

- A) Të përdori plane sa më të gjata
- B) Të montojë videon bazuar në ritmin (beat) e muzikës
- C) Të shtojë sa më shumë efekte video
- D) Të përdorë sa më shumë tranzicione

Pyetja 68

Çfarë teknike përdoret për të ngjeshur kohën në film?

- A) Cross-cutting
- B) Jump cut
- C) Match cut
- D) Montage

Pyetja 69

Çfarë kuptoni me rregullin e 180-gradë?

- A) Rregull për fokusin e kamerës
- B) Udhëzim për ndriçimin
- C) Rregull për të ruajtur orientimin në hapësirë të personazheve
- D) Teknikë për montazhin e zërit

Pyetja 70

Çfarë ndodh nëse thyhet rregulli i 180-gradëve?

- A) Planet janë të ç'fokusuara
- B) Shikuesi ç'orientohet në hapësirë
- C) Skena bëhet shumë e errët
- D) Skena humb sinkronizimin e zërit

Pyetja 71

Në një skenë me dialog, çfarë përfaqëson linja e 180-gradë?

- A) Gjatësinë e aktorëve
- B) Skemën e ndriçimit
- C) Linjën e shikimit mes personazheve
- D) Distancën nga kamera të aktorëve

Pyetja 72

Si mund të thyhet rregulla e 180-gradë për arsye krijuese?

- A) Duke përdorur portretin
- B) Duke pozicionuar kamerën në anën tjetër të aksit
- C) Duke përdorur zoom-in
- D) Duke ndryshuar ndriçimin

Pyetja 73

Çfarë është 'cutaway' në montazh?

- A) Kalim kohe mes skenave
- B) Mënyrë lëvizje e kamerës
- C) Plan që ndërpret skenën për të treguar diçka, në vënd tjetër
- D) Montazh i planeve pa audio

Pyetja 74

Si quhet procesi i vendosjes së planeve sipas rendit kronologjik të skenarit?

- A) Drafti i parë i montazhit(rough cut)
- B) Përcaktimi i dublës më të mirë
- C) Sinkronizim
- D) Dublim

Pyetja 75

Cila është faza përfundimtare e përpunimit të videos?

- A) Final cut
- B) Rough cut
- C) Post-production
- D) Color grading

Pyetja 76

Çfarë kuptoni me fjalën ritëm në montazh?

- A) Rrjedha e planeve dhe skenave e krijuar në montazh
- B) Shpejtësia e lëvizjes së kamerës

- C) Gjatësia e planit
- D) Cilësia e zërit

Pyetja 77

Çfarë kuptoni me montazh jo-linear?

- A) Montimi i materialit në një sekuencë nga fillimi deri në fund
- B) Montimi i materialit në mënyrë jo kronologjike
- C) Montimi i materialit në kompjuter me fleksibilitetin e riorganizmit të skenave
- D) Montimi i materialit pa zë

Pyetja 78

Çfarë është montazhi i padukshëm?

- A) Një lloj efekti vizual
- B) Stil montazhi ku prerjet nuk tërheqin vëmëndjen
- C) Një prerje inkuadrature
- D) Teknikë për të shtuar efektet vizuale

Pyetja 79

Çfarë është 'juxtaposition' i planeve?

- A) Montimi i planeve për të krahasuar ose krijuar kontrast
- B) Montazhi i dialogut
- C) Shtimi i muzikës
- D) Efektet speciale

Pyetja 80

Çfarë kuptoni me sinkronizim në montazh?

- A) Shtimi i muzikës së sfondit
- B) Miksimi i pistave të zërit
- C) Miksimi i pistave video
- D) Vendosja e saktë e frame të zërit me të videos

Pyetja 81

Si quhet filmi i parë me metrazh të gjatë i cili është xhiruar i gjithi me zë dhe muzikë?

- A) 'Metropolis'
- B) 'The Jazz Singer'
- C) 'City Lights'
- D) 'Gone with the Wind'

Pyetja 82

Në cilin vit u shfaq filmi 'The Jazz Singer'?

- A) 1927
- B) 1934
- C) 1938
- D) 1940

Pyetja 83

Çfarë ishte problem për zërin në filmat e parë me zë xhiruar jashtë studiove?

- A) Balancimi i ngjyrave
- B) Montazhi i zërit
- C) Gjetja e vëndeve të xhirimit
- D) Zhurma e sfondit

Pyetja 84

Si quhej paisja që kthen zërin në sinjal për tu regjistruar?

- A) Boks
- B) Projektor
- C) Mikrofon
- D) Kamera

Pyetja 85

Çfarë problemi solli regjistrimi i zërit, për videon?

- A) Kamerat duhet të futeshin në kuti të mëdha që izolonin zhurmat
- B) Aktorët duhej të flisnin me zë të lartë
- C) Mikrofonët nuk ishin të ndjeshëm
- D) Kinematë nuk kishin sistem të shpërndarjes së zërit

Pyetja 86

Çfarë ndryshimi solli zëri në prodhimin e filmit 35mm?

- A) Zëri duhej të regjistrohej në shirit tjetër
- B) Përmasa e filmit 35mm duhej të krijonte hapësirë për zërin
- C) Duheshin modifikuar kamerat
- D) Duhej një paisje specialë për sinkronizim

Pyetja 87

Si quhet procesi i regjistrimit të zërit në post-production?

- A) Miksazh
- B) Montazh
- C) Dublim
- D) Sinkronizim

Pyetja 88

Si quhej zhanri i filmave ku një pjesë e madhe e skenave përmbanin numra muzikorë?

- A) Film Noir
- B) Musical
- C) Comedy
- D) Thriller

Pyetja 89

Cili ishte regjisori i filmit 'M', i cili e përdori zërin në mënyrë inovative në filmat e tij?

- A) Fritz Lang
- B) Alfred Hitchcock
- C) Orson Welles
- D) John Ford

Pyetja 90

Çfarë kuptoni me procesin e miksazhit të zërit?

- A) Miksimi i dialogut, efekteve të zërit dhe muzikës në një projekt
- B) Miksimi i zërit me videon
- C) Miksimi i efekteve video
- D) Miksimi i zërit të ambjentit me dialogun

Pyetja 91

Çfarë u shpik në vitet '70 që solli zhvillim në fushën e zërit?

- A) Montazhi dixhital
- B) Filmi me ngjyra
- C) Efektet kompjuterike
- D) Zëri stereo

Pyetja 92

Cili ishte një nga filmat e parë që përdori regjistrimin me Dolby Stereo, në vitet '70?

- A) 'Jaws'
- B) 'The Godfather'
- C) 'Star Wars'
- D) 'Apocalypse Now'

Pyetja 93

Çfarë do të thotë 'ADR' në regjistrimin e zërit?

- A) Audio Data Recording
- B) Automated Dialogue Replacement
- C) Advanced Digital Recording
- D) Audio Dialogue Restoration

Pyetja 94

Cili mikrofon përdoret për të regjistruar dialogun?

- A) Lavalier microphone
- B) Dynamic microphone
- C) Condenser microphone
- D) Shotgun microphone

Pyetja 95

Sa sekonda zhurmë ambjenti sugjerohet të regjistrohet në shesh xhirim?

- A) 20s
- B) 60s
- C) 120s
- D) 180s

Pyetja 96

Kur përdoret mikrofoni lavalier?

- A) Regjistrimin e ambjentit
- B) Regjistrimin e muzikës
- C) Regjistrimin e dialogut kur nuk mund të përdoret shotgun
- D) Regjistrimin e efekteve të ndryshme të zërit

Pyetja 97

Çfarë prove duhet të bëjme me mikrofonin wireless përpara se të xhirojmë?

- A) Të kontrollojmë hyrjet në kamera
- B) Testim për interferencë
- C) Testim i frekuencës së rrjetit
- D) Të lëvizim ndriçimin

Pyetja 98

Pse është e rëndësishme që mikrofoni shotgun ta ketë ndjeshmërinë anësore sa më të ulët?

- A) Ndhmon efektet vizuale
- B) Ruan mikserin mos nxehet
- C) Siguron cilësi maksimale të zërit
- D) Përmirëson performancën e aktorëve

Pyetja 99

Cili është funksioni i 'boom operator' në shesh xhirim?

- A) Vendosja e ndriçimit
- B) Vendosja e këndeve të kamerës
- C) Koordinimi i aktorëve
- D) Vendosja e mikrofonit në pozicionin optimal për regjistrim

Pyetja 100

Çfarë informacioni përmban çaku, që i duhet zërit për sinkronizim?

- A) Numër skene, plani, dubël
- B) Emrin e regjisorit dhe drejtorit të fotografisë
- C) Llojin e objektivit të përdorur
- D) Informacion mbi vëndin e xhirimit

## **Kapitulli 7 Struktura e skenarit dhe etika në sheshxhirim**

Pyetja 1

Cila është struktura standarte me tre akte në film?

- A) Prezantimi, Kulmi, Zgjidhja
- B) Fillimi, Mesi, Fundi
- C) Ekspozimi, Konflikti, Mbyllja
- D) Ngjarja, Konflikti, Zgjidhja

Pyetja 2

Cili është qëllimi narrativ për skenën hapëse të një filmi?

- A) Climax
- B) Rising action
- C) Eksposition
- D) Inciting incident

Pyetja 3

Çfarë konsiderohet 'beat' në skenar?

- A) Tranzicion mes skenave
- B) Njësi e momentit në një skenë
- C) Notë muzikore
- D) Dialog

Pyetja 4

Çfarë quhet 'inciting incident' në film?

- A) Kulmi i ngjarjes
- B) Momenti që inician konfliktin kryesor
- C) Zgjidhja e konfliktit
- D) Skena finale

Pyetja 5

Çfarë është kulmi(climax) i filmit?

- A) Skena hapëse
- B) Prishja e rutinës
- C) Kthesa(turning point) ose momenti më tensionues
- D) Origjina e personazheve

Pyetja 6

Çfarë është 'subplot' në film?

- A) Linja kryesore e ngjarjes
- B) Një ngjarje dytësore paralele me ngjarjen kryesore
- C) Kulmi i ngjarjes
- D) E shkuara

Pyetja 7

Si quhet një segment i filmit që trajton të shkuarën?

- A) Retrospektivë
- B) Prezantim
- C) Elips
- D) Tranzicion

Pyetja 8

Cili është qëllimi i 'montage' në film?

- A) Të prezantojë personazhet kryesorë
- B) Të tregojë një seri ngjarjesh të shtrira në kohë
- C) Të theksojë pikën kulminante
- D) Të zgjidhë konfliktin kryesor

Pyetja 9

Në skenar, çfarë quhet 'plot point'?

- A) Një ndodhi e vogël në ngjarje
- B) Një ndodhi që komplikon ngjarjen
- C) Një pjesë dialogu
- D) Një vënd xhirimi

Pyetja 10

Cili është qëllimi i 'rising action' në film?

- A) Të prezantojë personazhet kryesorë
- B) Të rrisi tensionin dhe shkaktojë konflikt
- C) Të zgjidhë konfliktin kryesor
- D) Të prezantojë të shkuarën

Pyetja 11

Çfarë është rrugëtimi i personazhit(character's arc)?

- A) Stili vizual i personazhit
- B) Dialogu i personazhit
- C) Transformimi i personazhit gjatë ngjarjes
- D) Zgjidhja e konfliktit kryesor

Pyetja 12

Çfarë është 'midpoint' në strukturën e filmit?

- A) Fillimi i ngjarjes
- B) Pika kulmore e ngjarjes
- C) Ndodhi e rëndësishme që ndryshon drejtimin e ngjarjes
- D) Inciting incident

Pyetja 13

Çfarë është teknika e 'planting and payoff' në skenar?

- A) Të tregojë vëndin ku ndodh ngjarja
- B) Të prezantojë antagonistin
- C) Të prezantojë temën e filmit
- D) Të prezantojë një detaj, rëndësia e të cilit zbulohet më vonë

Pyetja 14

Kush është antagonisti në një film?

- A) Personazhi që i kundërvihet protagonistit
- B) Personazh dytësor
- C) Dashuria kryesore e protagonistit
- D) Personazhi kryesor

Pyetja 15

Çfarë është 'B-story' në skenar?

- A) Ngjarja kryesore
- B) E shkuara e antagonistit
- C) Ngjarje dytësore që tematikisht mbështet ngjarjen kryesore
- D) Pika kulmore e filmit

Pyetja 16

Një faqe skenari sa kohë filmike i korrespondon afërsisht?

- A) 30 sekonda
- B) 60 sekonda
- C) 90 sekonda
- D) 120 sekonda

Pyetja 17

Çfarë quhet 'turning point' në strukturën e filmit?

- A) Prezantimi i protagonistit
- B) Moment që ndryshon dukshëm drejtimin e ngjarjes

- C) Fundi i aktit të parë
- D) Akti final

Pyetja 18

Në formatin e skenarit, si shkruhen emrat e personazheve?

- A) Me shkronja kapitale
- B) Me shkronja të vogla
- C) Në paragraf të ri
- D) Te koka e skenës

Pyetja 19

Në skenar, kur përdoret 'FADE IN'?

- A) Mbarimi i një skene
- B) Fillimi i skenarit ose tranzicion
- C) Një ndryshim në skenë
- D) Një copëz dialogu

Pyetja 20

Cili është qëllimi i zgjidhjes(resolution) në film?

- A) Të fillojë aktin e dytë
- B) Të zhvillojë konfliktin
- C) Të mbyllë ngjarjen kryesore dhe dytësore
- D) Të komentojë mbi protagonistin

Pyetja 21

Çfarë duhet të bësh kur mbërrin në sheshin e xhirimit?

- A) Të fillosh të montosh paisjet
- B) Të njoftosh produksionin ose asistentin e parë të regjisë
- C) Të shkosh të craft services
- D) Të merresh me telefonin

Pyetja 22

Si mund të hysh në shesh xhirimi pasi ka filluar xhirimi?

- A) Pa bërë zhurmë
- B) Flet me zë të lartë
- C) Fik dritat
- D) Pret deri sa të mbarojë xhirimi

Pyetja 23

Nëse padashje bën një gabim që i kushton produksionit, si vepron?

- A) Nuk tregon
- B) Pret deri sa të mbarojë dita e xhimit për ta treguar
- C) Shkon te producenti dhe i tregon vetëm atij
- D) Menjëherë i tregon eprorit tënd

Pyetja 24

Nëse duhet të lëvizësh një paisje jo të departamentit tënd, si vepron?

- A) E lëviz menjëherë
- B) Pyet personin më të afërt
- C) Pret personin përgjegjës për atë paisje
- D) Bërtet me zë të lartë që do e lëvizësh

Pyetja 25

Si vepron me telefonin në shesh xhimi?

- A) E mban me zë në rast emergjencash
- B) E përdor sa herë të duhet gjatë xhimit
- C) E mban në silent dhe e përdor me kujdes në pushim
- D) E vë pranë mikrofonit

Pyetja 26

Si është mënyra e duhur e komunikimit me aktorët në shesh xhim?

- A) I jep udhëzime
- B) I bën me shenja gjatë performancës
- C) Prisni gjatë pushimit mes planeve
- D) Nëse nuk ju flasin, i lëmë të përqendrohen

Pyetja 27

Nëse je në linjën e shikimit të aktorit gjatë xhimit, si duhet të veprësh?

- A) I buzëqesh ose i shkel syrin
- B) I bën me shenjë të shikojë diku
- C) Bisedon me një pjesëtar të ekipit
- D) Rri i palëvizur me sytë në tokë për të mos tërhequr vëmendje

Pyetja 28

Kur mund të ulesh në shesh xhirim?

- A) Gjatë pushimit të ushqimit në mes të orarit
- B) Kur mbaron xhirimi i çdo plani
- C) Kur lëvizet kamera
- D) Kur regjistrohet vetëm zëri

Pyetja 29

Kur mund të fotografosh në shesh xhirim?

- A) Në çdo moment
- B) Vetëm gjatë pushimit me lejen e producentit
- C) Gjatë xhirimit të një dubli
- D) Kur aktorët të jenë me kostume

Pyetja 30

Si duhet të sillesh në rast debati ose konflikti në shesh xhirim?

- A) Përballesh me zë të lartë
- B) Injoron dhe vazhdon punën
- C) Diskuton me personin dhe shefin e departamentit, i veçuar
- D) Largohesh nga sheshi i xhirimit

## **Kapitulli 8. Estetika e teatrit**

Pyetja 1

Cili prej përshkrimeve do ta karakterizonte më saktësisht teatrin?

- A) Një formë arti që përfshin pikturën dhe skulpturën
- B) Arti i paraqitjes së një historie me ndihmën e muzikës dhe ndriçimit.
- C) Vepra dramatike e shfaqur në një skenë nga aktorët para një publiku
- D) Aktiviteti i një grupi njerëzish që luajnë, sipas rastit, edhe përpara një kamere

Pyetja 2

Cili koncept përjashtohet kur përkufizojmë fjalën “art” ?

- A) Arti është zotësi
- B) Arti është mënyrë për të fituar
- C) Arti është pasqyrim i së bukurës
- D) Arti është domethënie

Pyetja 3

Cila pyetje nuk do të kishte shumë interes për estetët?

- A) Ç'është e bukura?
- B) Ç'është arti?
- C) A ka bukuria ekzistencë objektive?
- D) A lidhet e bukura me racat njerëzore?

Pyetja 4

Cili pohim në lidhje me artin do të ishte i dyshimtë?

- A) Arti është formë e shprehjes njerëzore
- B) Arti na ngacmon në ndjenja dhe emocione
- C) Arti egziston pavarësisht njeriut
- D) Arti na pajis me ndjenjën e rregullit

Pyetja 5

Misioni i artit

- A) Është të zbavisë atë që e konsumon
- B) Është që ta përjashtojë kënaqësinë dhe zbavitjen nga qëllimi i tij
- C) Është të edukojë nëpërmjet zbavitjes
- D) Është të edukojë dhe ta pajisë nga ana morale atë të cilit i drejtohet

Pyetja 6

Këto janë parime të përbashkëta për të gjitha artet, me përjashtim të:

- A) Unitetit
- B) Ansamblit
- C) Koherencës
- D) Intensitetit

Pyetja 7

Përse do na na duhej kryesisht studimi i teatrit?

- A) Sepse çdo shoqëri ka pasur dhe ka teatrin e saj
- B) Teatri na ndihmon të kuptojmë botën dhe vendin që ne zëmë në të
- C) Për të plotësuar kulturën tonë të përgjithshme
- D) Për ta parë si mundësi punësimi

Pyetja 8

Çfarë është "Poetika" e Aristotelit?

- A) Roman
- B) Traktat estetik
- C) Komedi

D) Ese filozofike

Pyetja 9

Cili është qëllimi kryesor i “Poetikës” së Aristotelit?

- A) Të përshkruajë jetën e poetëve të lashtë
- B) Të kritikojë veprat e poetëve të antikitetit
- C) Të analizojë natyrën e tragjedisë
- D) Të promovojë komedinë

Pyetja 10

Cili shpjegim i përafrohet termit “mimesi” ashtu siç e konceptonte atë Aristoteli?

- A) Rikrijim i realitetit ideal
- B) Besnikëri ndaj realitetit
- C) Zbukurim i realitetit
- D) Imitim i realitetit

Pyetja 11

Cili është termi që Aristoteli përdor për të përshkruar ndjenjat e përdorura në tragjedi?

- A) Pathos
- B) Ethos
- C) Logos
- D) Mythos

Pyetja 12

“Deus ex machina”:

- A) Ka kuptimin e makinerive për të krijuar efektet në teatrin grek
- B) Ka kuptimin e makinerive që përdoren për të lëvizur dekoret
- C) Do të thotë zgjidhje dramatike që vjen nga një forcë e mbinatyrshme
- D) Ishtë një rit i vjetër që ishte futur në teatër nga priftërinjtë

Pyetja 13

Kur flasim për termin “katarsis” kemi parasysh:

- A) Katastrofën pas së cilës vjen qetësia shpirtërore
- B) Pjesmarrjen në një ritual për të trembur shpirtrat e këqinj
- C) Lutjen fetare për të shprehur adhurimin ndaj një force të mbinatyrshme
- D) Pastrimin shpirtëror nëpërmjet kontaktit me veprën artistike

Pyetja 14

Cili nga elementet nuk lidhet me teatrin e antikitetit?

- A) Kori

- B) Maskat
- C) Vallet
- D) Muri i katërt

Pyetja 15

Shumica e studiuesve besojnë se:

- A) Muzika në teatrin grek kishte vetëm karakter shoqëruës
- B) Muzika ka qenë pjesë e pandashme e shfaqjes
- C) Muzika luhej vetëm në pushim të shfaqjes
- D) Muzika luhej me mjete rrethanore

Pyetja 16

Cili nga vlerësimet e mëposhtme në lidhje me ritualin nuk është i vërtetë?

- A) Rituali është një formë e dijes
- B) Rituali nuk shërben për të zbavitur dhe për të dhënë kënaqësi
- C) Ka karakter didaktik
- D) Shërben për të ushtruar ndikim ose kontroll mbi forca që qëndrojnë mbi njeriun

Pyetja 17

Kur flet për “paradoksin e aktorit”, Denis Didroi ka parasysh:

- A) Shkrijën e aktorit me rolin e tij
- B) Lojën melodramatike
- C) Aktori nuk duhet të ketë asnjë lloj ndjeshmërie
- D) Vetpërmbajtjen emocionale të aktorit

Pyetja 18

Tek vepra “Paradoksi i aktorit” të Didëroit, fjala “paradoks”, ka kuptimin:

- A) E vërtetë
- B) Jo e vërtetë
- C) Që duket si e vërtetë, por nuk është
- D) Që nuk duket si e vërtetë, por mund të jetë

Pyetja 19

Doktrina e klasicizmit francez kërkonte që:

- A) Personazhet të paraqiteshin jo ashtu siç janë, por siç duhet të jenë
- B) Personazhet të paraqiteshin ashtu siç janë në realitet
- C) Personazhet të paraqiteshin më të këqinj se ç’janë në realitet.
- D) Personazhet të paraqiteshin më të mirë se ç’janë në realitet

Pyetja 20

Çfarë nuk përputhet me rregullat neoklasike?

- A) Që vepra duhej të kishte një ekuilibër të jashtëm e të brendshëm të dukshëm
- B) Të kishte tema me karakter universal
- C) Të respektonte normat e mirësjelljes, të shijes së shëndoshë
- D) Që zhanret, komikja me tragjiken apo liriken mund të përziheshin

Pyetja 21

Në lidhje me “tri unitetet” në dramën neoklasike:

- A) Uniteti i vendit mund të anashkalohet
- B) Uniteti i kohës mund të zëvendësohet me atë të vendit
- C) Ai i veprimit duket i vështirë për t’u respektuar
- D) Uniteti i veprimit është më i rëndësishmi

Pyetja 22

Nuk i përket klasicizmit francez parimi që:

- A) Detyra duhet të mbisundojë mbi pasionin
- B) Arsyeja të mbisundojë mbi ndjenjën
- C) Vepra duhet të ketë karakter didaktik, edukativ
- D) Heroi i veprës duhet të arratiset nga realiteti që e rrethon

Pyetja 23

Sipas neoklasicizmit, uniteti i kohës kërkonte që:

- A) Pjesa duhej të ndodhte brenda dekadës së fundit
- B) Veprimi i pjesës të ndodhte brenda një dite të vetme
- C) Drafti i parë duhej të shkruhej në një sesion të vetëm
- D) Pjesa duhej të kufizohej në një vendndodhje

Pyetja 24

Kush konsiderohet figura qendrore e teatrit?

- A) Aktori
- B) Regjisori
- C) Dramaturgu
- D) Menaxheri

Pyetja 25

Marrëveshja midis publikut dhe artistëve të teatrit për të konsideruar atë që ndodh në skenë si të vërtetë, quhet:

- A) Kontratë
- B) Probabilitet

- C) Konvencion
- D) Sikur

Pyetja 26

Gordon Greigu e konsideronte teatrin:

- A) Thjesht si egzekutim
- B) Si mundësi për t'iu qasur jetës
- C) Si art
- D) Me pak mundësi shprehjeje

Pyetja 27

Për çfarë u shërbejnë kritikëve teoritë letrare si formalizmi, strukturalizmi apo marksizmi?

- A) Për të parashikuar ndikimin e përgjithshëm kulturor të një vepre
- B) Si një fjalor që është i kuptueshëm nga një publik i gjerë
- C) Si një listë cilësish që e bëjnë një vepër të suksesshme
- D) Për një botëkuptim dhe pikëpamje specifike për analizimin e një teksti apo shfaqje

Pyetja 28

Këto janë parime të përbashkëta për të gjitha artet, me përjashtim të:

- A) Unitetit
- B) Koherencës
- C) Intensitetit
- D) Ansamblit

Pyetja 29

Themi se një vepër skenike është koherente:

- A) Edhe kur forma dhe përmbajtja nuk harmonizohen me njëra tjetrën
- B) Kur përmbajtja e saj ka përkim me kohën kur jetojmë
- C) Kur ritmi dhe tempoja janë ndërtuar saktë
- D) Kur çdo pjesë është e lidhur me të tërën dhe rrjedh nga pjesa parardhëse

Pyetja 30

Brehti, ndryshe nga Stanislavski, nuk kërkon që aktori:

- A) Të mbaj qëndrim kritik ndaj personazhit
- B) Të emocionojë publikun
- C) Ta bëjë publikun të mendojë dhe të gjykojë
- D) Të krijojë në skenë iluzionin e realitetit

Pyetja 31

Teatri epik quhet kështu sepse:

- A) Mbështetet mbi një vepër të shkruar në prozë
- B) Ishte antiaristotelian
- C) Kërkonte të krijonte iluzionin e realitetit
- D) Donte që spektatori të shkrihej me ngjarjen skenike

Pyetja 32

Sipas Brehtit, “Të transformosh teatrin do të thotë të transformosh...”, cilin?

- A) Aktorin
- B) Dramaturgun
- C) Regjisorin
- D) Publikun

Pyetja 33

Brehti kërkonte që spektatori:

- A) Vetëm të zbavitej me shfaqjen
- B) Të mos distancohej prej saj
- C) Vetëm ta shijonte atë estetikisht
- D) Të vihej në pozita gjykuese për ngjarjen skenike

Pyetja 34

Në teatrin realist nuk ndodh që:

- A) Subjekti të pasqyrojë ngjarje që publiku i ndesh në jetën e përditëshme
- B) Veprimi të kufizohet në vende reale
- C) Koha të kalojë si në jetën e përditëshme
- D) Gjuha të mund të jetë në vargje si tek shumë pjesë të Shekspirit

Pyetja 35

“Teatri i varfër”, një term i përdorur nga Grotovski:

- A) Tregon se është një teatër për shtresat e varfra të popullsisë
- B) Nuk i kushton shumë rëndësi marrëdhënies së aktorit me publikun
- C) I kushton më shumë rëndësi marrëdhënies së aktorit me publikun
- D) Është teatër i mjeteve të pakta financiare

Pyetja 36

Alegori do të thotë:

- A) Paraqitja e temave abstrakte nëpërmjet përdorimit simbolik të elementeve dramatik
- B) Dramë që e vë theksin kryesor në trajtimin e ideve morale dhe filozofike
- C) Dramatizim i gjendjetve subjektive me anë të formave të deformuara
- D) Pasqyrimi i botës së ëndrrave dhe maktheve njerëzore

Pyetja 37

Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me “avangardën” nuk është i vërtetë?

- A) “Avangardë” është një term që vjen nga frëngjishtja dhe përkthehet “pararojë”
- B) Ajo tregon një lëvizje intelektuale, letrare ose artistike që thyen rregullat e traditës
- C) Avangarda kishte gjithashtu një karakter të theksuar militarist
- D) Në përgjithësi, veprat e avangardës janë eksperimentale

Pyetja 38

Cili nga elementet nuk është i përbashkët kur bëhet fjalë për filmin dhe teatrin?

- A) Forma dramatike
- B) Prania e drejtpërdrejtë e publikut në një hapësirë të vetme
- C) Prania e aktorëve
- D) Efektet zanore

Pyetja 39

Funksioni i teatrit:

- A) Nuk ndryshon nga një epokë në tjetrën
- B) Ndryshon por thelbi mbetet i njëjtë
- C) Nuk ka qenë në asnjë epokë i njëjtë
- D) I përshtatet kushteve dhe rrethanave të çdo epoqe

Pyetja 40

Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me funksionin e teatrit në epoka të ndryshme nuk është i vërtetë?

- A) Teatri, gjatë historisë ka qenë shpesh mjet parësor mësimdhënies
- B) Teatri mesjetar jepte mësimet e Biblës dhe të Kristianizmit
- C) Teatri në periudhën komuniste në Shqipëri shërbente për edukimin e masave
- D) Teatri, në antikitet, kishte vetëm funksion fetar

Pyetja 41

Brehti e arrinte efektin e distancimit me elementet e mëposhtme, me përjashtim të:

- A) Karakterit episodik të dramave të shfaqura
- B) Narracionit (rrëfimit) të këngëzuar
- C) Afisheve të mëdha dhe tabelave që lajmërojnë ndryshimet e skenave
- D) Faktit që aktorët nuk i flisnin asnjëherë direkt spektatorit

Pyetja 42

Nga perspektiva e hapësirës dhe e kohës, teatri është art që:

- A) Realizohet vetëm në hapësirë
- B) Realizohet vetëm në kohë
- C) Realizohet në hapësirë dhe në kohë

D) Nuk realizohet as në hapësirë, as në kohë

Pyetja 43

Çfarë nënkupton Samuel Beketi me këtë pohim: “Forma, struktura dhe shpirti i një pohimi artistik nuk mund të ndahet nga kuptimi, përmbajtja konceptuale, sepse vepra e artit si e tërë është domethënia e saj, çfarë thuhet në të është e lidhur pazgjidhshmërisht me mënyrën se si thuhet dhe me pamundësinë për të gjetur një mënyrë tjetër për ta thënë”?

- A) Vepra artistike është forma
- B) Përmbajtja është gjithçka në një vepër artistike
- C) Forma është më e rëndësishme se përmbajtja
- D) Përmbajtja është e pashkëputur nga forma

Pyetja 44

Kur përdor shprehjen “pohim artistik”, Beketi nënkupton:

- A) Idenë e përgjithshme
- B) Idenë e përgjithshme me imazhin artistik
- C) Imazhin artistik
- D) Temën kryesore

Pyetja 45

Qëllimi i teknikës është:

- A) Ta bëjë sa më të lehtë punën e artistit
- B) Teknika ka vlerë në vetvete
- C) Subjekti të komunikohet sa më qartë e sa më fuqishëm
- D) Ta kthejë artin në zanat

Pyetja 46

Cili do të ishte objektivi kryesor i lëndës së teatrit në një shkollë të mesme?

- A) Që të rinjtë të kenë një krijimtari të tyren në fushën e teatrit
- B) Të vlerësojnë botën në mënyrë krijuese dhe kritike në perspektivën e aspekteve që edukon teatri sidomos shpirtin e tij të bashkëpunimit
- C) Të rrisin ndjenjën e vetëbesimit
- D) Të jenë të motivuar që të përfshihen në mënyrë aktive në jetën teatrale-artistike të shkollës

Pyetja 47

Një mësues teatri i një shkolle të mesme po u paraqet nxënësve një mësim rreth përgjegjësive të regjisorit në një shfaqje teatrale. Cila nga veprimtaritë do të ishte më e përshtatshme për formimin e nxënësit lidhur me këtë temë?

- A) Shkrimi i një eseje mbi zhvillimin historik të rolit të regjisorit
- B) Duke parë videot e dy shfaqjeve të ndryshme të së njëjtës pjesë

- C) Duke intervistuar një regjisor dhe duke shkruar një raport mbi mënyrën si ai punon
- D) Duke lexuar një fragment të shkurtër nga një pjese dhe duke i kërkuar klasës se si do të trajtohej skena nëse do të ishin ata vetë regjisorë

Pyetja 48

Në punë me nxënësit e gjimnazit, cili do të ishte objektivi më i arritshëm?

- A) Që nxënësit të luajnë si profesionistë
- B) Që të zbulohet kush janë më të talentuarit
- C) Që nxënësit të forcojnë pasionin për teatrin
- D) Që nxënësit të zbaviten sa më shumë

Pyetja 49

Cili nga elementet e mëposhtëm të teatrit do të ishte më i dobishëm për t'u synuar në një klasë gjimnazi?

- A) Roli i dramës në kultura të ndryshme botërore
- B) Procesi krijues bashkëpunues
- C) Lidhja midis aktorëve dhe publikut
- D) Temat universale që gjenden në dramë

## **Kapitulli 9. Aktrimi**

Pyetja 1

Objekti i artit të aktorit është:

- A) Interpretimi i karakterit dramatik
- B) Analiza e karakterit dramatik
- C) Imitimi i karakterit dramatik
- D) Rikrijimi i ngarjes dramatike

Pyetja 2

“Aktor” është një term që vjen nga latinishtja dhe do të thotë:

- A) Imitues
- B) Veprues
- C) Manipulator
- D) Përqeshës

Pyetja 3

Kërkesa bazë e sistemi të Stanislavskit mbi interpretimin e aktorit është:

- A) Për imitim sa më të mirë të personazhit

- B) Kërkesa për vërtetësi
- C) Kërkesa për një të folur sa më të bukur
- D) Kërkesa për ta paraqitur personazhin sa më mirë nga ana e jashtme

Pyetja 4

Në çfarë diateze duhet të jetë folja që ta mbart sa më mirë shprehjen e veprimit?

- A) Pësore
- B) Veprare
- C) Vetvetore
- D) Urdhërore

Pyetja 5

Cila nga foljet e mëposhtme do të ishte më e përshtatshme për t'u përdorur si veprim?

- A) Zbavitem
- B) Paralajmëroj
- C) Gëzohem
- D) Lëviz

Pyetja 6

Me çfarë pyetje gjendet përshtatja?

- A) Çfarë?
- B) Ku?
- C) Si?
- D) Me kë?

Pyetja 7

Instrumenti që përdor aktori për egzekutimin e rolit është:

- A) Zëri
- B) Mimika
- C) Plastika trupore
- D) Vetvetja

Pyetja 8

Mjeti kryesor që përdor aktori për realizimin e karakterit është:

- A) Intonacioni i zërit
- B) Plastika trupore
- C) Veprimi
- D) Ndjenja

Pyetja 9

Në marrëdhënien regjisor-aktor:

- A) Është regjisori ai që vendos
- B) Aktori është vetë ai përgjegjës për punën e tij
- C) Duhet të mbisundojë fryma e bashkëpunimit
- D) Aktori duhet të respektojë regjisorin

Pyetja 10

Bërthama artistike e rolit është:

- A) Thelbi i mendimeve të pashprehura asnjëherë prej karakterit
- B) Tërësia e tipareve të brendshme dhe të jashtme të karakterit
- C) Halli i tij kryesor për të cilin jepet me gjithçka
- D) Mënyra se si sillet dhe lëviz në skenë

Pyetja 11

Tregues se kush është njeriu në jetë dhe personazhi në skenë, janë:

- A) Bëmat dhe veprimet e tij
- B) Opinionet e të tjerëve
- C) Mënyra e veshjes
- D) Modeli i flokëve

Pyetja 12

Nëse do të na duhej të ndërtonim një gramatikë të teatrit, kryefjala do të ishte:

- A) Tema
- B) Ideja
- C) Mesazhi
- D) Karakteri

Pyetja 13

Nëse do të na duhej të ndërtonim një gramatikë të teatrit, kallëzuesi do të ishte:

- A) Subjekti
- B) Konflikti
- C) Veprimi
- D) Monologu

Pyetja 14

Në përpilimin e skedës së personazhit nuk ka rëndësi:

- A) Çfarë thonë dhe mendojnë personazhet e tjerë për të
- B) Çfarë mendon publiku për të
- C) Çfarë thotë dhe mendon ai ose ajo për vete
- D) Çfarë thotë dhe mendon autori për të

Pyetja 15

Si mund ta kuptojmë këtë shprehje të Xhorxh Bernard Shou-t, “Arti i shkrimtarit, megjithëse shumë i përpunuar gramatikisht, është i pafuqishëm kur bëhet fjalë për intonacionin; ka njëqind mënyra për të thënë “po” dhe “jo”, ndërkohë që ka vetëm një mënyrë për t’i shkruar”.

- A) Që intonacioni i fjalës është mjeti më i rëndësishëm i artit të aktorit
- B) Që në interpretim, rëndësi ka se me çfarë qëllimi thuhet fjala dhe cili është nënteksti
- C) Që letërsia është inferiore dhe e pafuqishme kur krahasohet me teatrin
- D) Që vepra dramatike ka rëndësi relative kur vjen fjala te interpretimi i aktorit

Pyetja 16

Intonacioni i fjalës:

- A) Është qëllim dhe jo mjet
- B) Është mjet dhe jo qëllim
- C) Nuk varet nga veprimi
- D) Varet nga rezultati

Pyetja 17

Kur flitet për intonacionin, aktori duhet të ketë parasysh:

- A) Që të luajë sa më shumë me të
- B) Që të mos luajë me intonacionin
- C) Se duhet të bësh prova me intonacioni para se të hysh në skenë
- D) Se intonacioni duhet fiksuar.

Pyetja 18

Fjala në teatër:

- A) Shërben për të shpjeguar situatën
- B) Është mjet i rëndësishëm narracioni (rrëfimi)
- C) Është mjet i rëndësishëm veprimi
- D) Ka një vlerë relative në krahasim me mjetet e tjera shprehëse

Pyetja 19

Kur personazhi shqipton fjalët e autorit:

- A) Ai ka nevojë t’i tregojë diçka publikut
- B) Ka nevojë t’i komunikojë diçka partnerit
- C) Ka nevojë të ndikojë në vetëdijen e partnerit për ta ndryshuar atë
- D) Ka një nevojë instinktive për të bërë diçka

Pyetja 20

Ku ndryshon përshtatja nga veprimi?

- A) Veprimi është i vetëdijshëm kurse përshtatja jo
- B) Veprimin e nxjerrim nga pjesa kurse përshtatja lind aty për aty

- C) Kryerja e veprimit nuk kërkon spontaneitet
- D) Të dyja nuk kanë të bëjnë me mënyrën e sjelljes së personazhit

#### Pyetja 21

Fuqia e aktorit për përshtatje interesante varet kryesisht nga:

- A) Inteligjenca e aktorit
- B) Nga fuqia e tij analizuese
- C) Nga talenti i tij
- D) Nga përshtatshmëria e tij fizike me rolin

#### Pyetja 22

Përshtatjet:

- A) Janë të vetëdijshme
- B) Janë të pavetëdijshme
- C) Jepen nga autori
- D) Lindin nga aktori

#### Pyetja 23

Kërkesa për të krijuar marrëdhënie me partnerë, do të thotë:

- A) Ta humbasim marrëdhënien me publikun
- B) Ta harrojmë që publiku egziston
- C) Të komunikojmë me publikun në mënyrë të tërthortë
- D) Të japim për publikun por ne të mos marrim

#### Pyetja 24

Çfarë nuk pajtohet me marrëdhënien e vërtetë me partnerë?

- A) Të dëgjuarit dhe të shikuarit konkret në skenë
- B) Të qenit e ndërsjelltë
- C) Të luajturit për vete
- D) Të komunikuarit si për herë të parë

#### Pyetja 25

Kur flasim për veprimin, kemi parasysht:

- A) Nevojat dhe dëshirat e personazhit
- B) Atë që synon të arrijë personazhi
- C) Atë që bën për të arritur qëllimin
- D) Lëvizjet e ndryshme që ai realizon

#### Pyetja 26

Veprimi është:

- A) Vetëm lëvizja që shohim e personazhit
- B) Vetëm ajo lëvizje që nuk shohim
- C) Të dyja llojet e lëvizjeve
- D) Ajo që shohim pasi është kryer lëvizja

Pyetja 27

Pse themi se veprimi ka karakter psiko-fizik?

- A) Sepse lind nga një dhimbje fizike
- B) Sepse lind nga një dhimbje psikike
- C) Sepse lind si lëvizje e brendshme por nuk gjen shprehje të jashtme
- D) Sepse lind si përjetim psikik, por shfaqet si energji fizike

Pyetja 28

Ngjarja është ajo ndodhi në jetën e një njeriu ose të një personazhit në skenë, e cila ka vetinë:

- A) Që ta frenojë ose përshpejtojë rrjedhën e veprimit
- B) Që ta ndryshojë rrjedhën e veprimit
- C) Që të jetë e shkëputur nga jeta e personazhit
- D) Që të mos i ndryshojë rrethanat

Pyetja 29

Një regjisor mund të ndihmojë një aktor të forcojë zhvillimin e karakterit duke i bërë të qartë atij se çfarë synon mbi të gjitha personazhi që ai interpreton, gjë që më së shpeshti quhet:

- A) Superdetyra
- B) Pengesa kryesor
- C) Nxitësit
- D) Rrethanat e dhëna

Pyetja 30

Kur flasim për ndihmesën e kujtesës emocionale në krijimin e rolit, kemi parasysh:

- A) Cilët janë disa nga aktorët që e kanë interpretuar më parë rolin
- B) Cilat përvoja domethënëse nga jeta e aktorit mund të shfrytëzohen për krijimin e rolit
- C) Çfarë pengesash has personazhi për arritjen e objektivit të tij
- D) Çfarë informacioni jepet në lidhje me përvojat e personazhit para se të fillojë shfaqja

Pyetja 31

Cili do të ishte termi që shpreh aksionin kryesor në një dramë?

- A) Veprimi përshkues
- B) Tema
- C) Konflikti
- D) Subjekti

Pyetja 32

Çfarë është “monologu”?

- A) Një dialog midis dy personazheve
- B) Një personazh që flet vetëm për veten
- C) Një personazh që shpreh mendimet pa u drejtuar detyrimisht personazheve të tjerë
- D) Një personazh që flet direkt me publikun

Pyetja 33

Cila do të ishte një nga përfitimet më të mëdha të trajnimit të aktorit?

- A) Përmirësimi i aftësisë për të vendosur dritat në skenë
- B) Zhvillimi i aftësisë për të përdorur efekte speciale
- C) Rritja e vetëbesimit dhe aftësisë për të komunikuar efektivisht
- D) Nxitja e interesit për të mësuar instrumente muzikore të reja

Pyetja 34

Qëllimi i punës me monologun është:

- A) Nxënësi të demonstrojë aftësi të spikatura në zbërthimin analitik letrar
- B) Të kuptojë karakterin e personazhit dhe ta imitojë atë sa më mire
- C) Të kap cilësitë e brendshme dhe të jashtme të karakterin dhe t'i konkretizojë me anë të fjalës.
- D) Të mësojë të flasë sa më bukur dhe në mënyrë sa më korrekte gjuhën shqipe

Pyetja 35

Stanisllavski ishte i pari që:

- A) E shndërroi mjeshtërinë e aktorit në sistem
- B) Kishte kërkesa për interpretim realist
- C) Vlerësoi artin e aktorit
- D) Vuri në skenë një pjesë me kërkesa regjisoriale profesionale

Pyetja 36

Veprimi boshtor i një vepre dramatike:

- A) Është kundërveprimi midis personazhit antagonist dhe protagonist për arritjen e qëllimit kryesor
- B) Është ideja dhe qëllimi kryesor i grupit të personazheve dhe buron nga veprimin i secilit personazh individual
- C) Synon të realizojë nevojën dhe qëllimin apo idealin e personazhit kryesor në vepër
- D) Nuk ka të bëjë detyrimisht me idenë kryesore dhe nuk buron detyrimisht prej saj

Pyetja 37

Stanisllavskit i interesojnë në mënyrë të veçantë këto unitet, me përjashtim të:

- A) Unitetit të hapësirës dhe kohës
- B) Unitetit të fizikes me psikiken

- C) Unitetit të trupit dhe shpirtit
- D) Unitetit të aktorit figurë dhe aktorit njeri

Pyetja 38

Stanislavski:

- A) U mbështet vetëm në artin e të paraqiturit
- B) Harmonizoi artin e të përjetuarit dhe artin e të paraqiturit
- C) U mbështet vetëm në artin e të përjetuarit
- D) Kishte interes vetëm për përrmbajten

Pyetja 39

Mbi cilin nga konceptet e mëposhtme do mbështetej trajnimi i aktorëve sipas metodës së Mejerholdit?

- A) Stërviçja e mendjes është më e rëndësishme sesa stërviçja e trupit
- B) Shqisat janë çelësi i zhvillimit të karakterit
- C) Sjellja e një interpretuesi duhet të pasqyrojë jetën e përditshme
- D) Emocioni lind gjatë lëvizjes

Pyetja 40

Për të pasqyruar stilin që përfaqësohet me atë të aktorëve të dikurshëm të Molierit, aktorët bashkëkohorë duhet ta modelojnë teknikën e tyre fizike dhe vokale sipas metodës:

- A) Së Konstantin Stanislavskit
- B) “Comedia dell'arte,,
- C) Teatrit të absurdit
- D) Teatrit të lirë

Pyetja 41

Çfarë përfaqëson metoda e Li Strasbergut në kontekstin e aktrimit?

- A) Një teknikë për të mësuar tekstin
- B) Përdorimin e kostumeve dhe detajeve për të përshkruar një karakter
- C) Një shkollë të ndryshme artistike për të kuptuarit e rolit
- D) Përdorimin e ndjenjave personale dhe përvojës individuale për të portretizuar një karakter

Pyetja 42

Cili prej këtyre faktorëve mendoni se ka më shumë ndikim në realizimin e një karakteri të besueshëm në skenë?

- A) Kostumet dhe rekuizita.
- B) Teksti dhe dialogu
- C) Grimi
- D) Përdorimi i mjeteve teknike të ndryshme

## Kapitulli 10. Regjiswa

### Pyetja 1

Në marrëdhënien regjisor-aktor:

- A) Është regjisor i ai që vendos
- B) Aktori është vetë ai përgjegjës për punën e tij
- C) Duhet të mbisundojë frymën e bashkëpunimit
- D) Aktori duhet të respektojë regjisorin

### Pyetja 2

Skenografia në teatër nuk duhet të jetë:

- A) Funksionale
- B) Simbolike
- C) Metaforike
- D) Dekorative

### Pyetja 3

“Regjisor”, është një term, rrënja e të cilit:

- A) Përkthehet “mbret”
- B) Ngjan me “dirigjent” që ka kuptimin drejtues
- C) Përkthehet “regjistruar”
- D) Nuk ka ngjashmëri me ekuivalentin e saj “director” të anglishtes

### Pyetja 4

Përpara se të lindte regjia si art i mëvetshëm, rolin e regjisorit e luanin këta persona me përjashtim të:

- A) Dramaturgut
- B) Koreografit
- C) Aktorit kryesor
- D) Qytetarit që e financonte

### Pyetja 5

Shkolla jonë e artit dramatik ka tendencë të përgjithshme të formojë regjisorin:

- A) Që beson se shfaqja është e tij
- B) Që është thjesht një egzekutues
- C) Që beson se regjia është art i pastër si piktura dhe muzika
- D) Që e bashkon trajtimin, interpretimin dhe krijimin në një

Pyetja 6

“Arti im është i destinuar të ekzistojë si një medium midis autorit dhe spektatorit”,- thoshte regjisori i shquar Xhorxhio Strehleri. Në këtë mënyrë ai mbronte idenë se:

- A) Regjisori ka rol dytësor në teatër
- B) Në teatër roli udhëheqës i takon autorit
- C) Se teatri është i regjisorit
- D) Teatri i takon spektatorit

Pyetja 7

Krijimi i atmosferës na ndihmon:

- A) Për ta bërë sa më të lehtë kuptimin e subjektit
- B) Për të projektuar esencën e shfaqjes, gjendjen dhe shpirtin e saj
- C) Thjesht për t'i shtuar ca ngjyra më tepër
- D) Për ta lehtësuar dhe bërë më zbavitëse

Pyetja 8

Çfarë mjetesh nuk përdor regjia ekspresioniste?

- A) Mjete që vënë në pah përmbajtjen ideore të veprës
- B) Dekore që përngjasojnë me pamjet e jashtme të realitetit
- C) Efektet e ndriçimit
- D) Shkallë të shumta, skela, katrorë dhe kube abstrakte

Pyetja 9

Çfarë nuk është pjesë e platformës regjisoriale?

- A) Qëndrimi i regjisorit ndaj problemeve të trajtuara në vepër
- B) Koncepti dhe vizioni regjisorial.
- C) Koncepti skenografik dhe sheshi i veprimit.
- D) Të përcaktosh se si do të reagojë publiku gjatë shfaqjes

Pyetja 10

Kur themi se një pjesë është aktuale kemi parasysh që:

- A) Nuk është universale
- B) Nuk i fliste kohës kur u shkruajt
- C) I flet kohës sonë
- D) Ka vlerë vetëm për kohën kur u shkruajt

Pyetja 11

Stili është shkalla e ngjashmërisë me jetën që shkrimtari ka përdorur në vepër. Duke pasur parasysh këtë fakt, cili stil do t'i përafrohej më shumë jetës?

- A) Klasik
- B) Realist

- C) Ekspresionist
- D) Romantik

Pyetja 12

Stili i shfaqjes:

- A) Është çështje forme
- B) Është çështje përmbajtjeje
- C) Lidhet me dramaturgun
- D) Lidhet me dramaturgun dhe me regjisorin

Pyetja 13

Lëvizja skenike është?

- A) Fiksimi i shfaqjes në hapësirë
- B) Projektimi i shfaqjes në kohë
- C) Vetëm konceptuale
- D) Vetëm teknike

Pyetja 14

Kompozicioni mizansenal është çështje:

- A) Forme
- B) Përmbajtje
- C) Forme dhe përmbajtje
- D) E tablosë skenike

Pyetja 15

Çfarë nuk përfshihet në kompozicionin mizansenal?

- A) Ana teknike mizansenale
- B) Struktura, forma ose organizimi hapësinor i grupit
- C) Cilësia dhe atmosferën e subjektit nëpërmjet ngjyrës, vijës, masës dhe formës
- D) Kostumet dhe atmosfera e ngjyrave

Pyetja 16

Teknikisht, evidentimi në grupimin mizansenal arrihet nëpërmjet këyre faktorëve përveçse:

- A) Nëpërmjet largësisë nga qendra e skenës
- B) Nëpërmjet planeve
- C) Nëpërmjet niveleve
- D) Nëpërmjet kornizës skenike

Pyetja 17

Çfarë bën regjisorin për të përcaktuar veprimin boshtor të një pjese?

- A) Krijon një listë të detajuar të rekuizitës dhe objekteve të tjera skenike
- B) Cakton orarin se kur duhen dhe kur nuk duhen aktorët në prova
- C) Parashikon sfidat teknike që ka të ngjarë të hasen gjatë shfaqjes
- D) Përcakton mesazhin qëndror që do të përcjellë nëpërmjet karaktereve dhe subjektit

#### Pyetja 18

Në lidhje me bashkëpunimin me skenografin, cila nga përgjegjësitë në vijim është më e rëndësishme për regjisorin?

- A) Buxhetimi i materialeve të skenografisë
- B) Programimi i kohës për ndërtimin e saj
- C) Komunikimi i ideve dhe konceptit pamor të shfaqjes
- D) Që objektet të mos pengojnë ndriçimin e skenës

#### Pyetja 19

Për të unifikuar shfaqjen, regjisorit i duhet të zhvillojë një koncept ose qasje të tij, e cila mund të fillojë të zhvillohet duke zbërthye përplasjen midis forcave të kundërta në dramë, e cila ndryshe quhet:

- A) Polet e kundërta
- B) Konflikti qëndror
- C) Pengesa kryesore
- D) Rrethanat e dhëna

#### Pyetja 20

Temporiteti nuk ka të bëjë me:

- A) Kohën
- B) Intensitetin
- C) Pamjen
- D) Frekuencën

#### Pyetja 21

Ritëm do të thotë:

- A) Valë
- B) Rrahje
- C) Hap
- D) Rrjedhë

#### Pyetja 22

Ritmi nuk varet nga:

- A) Personazhi
- B) Nga ngjarja që nuk ka ndodhur ende
- C) Rrethanat

D) Vendi i veprimit

Pyetja 23

Çfarë nuk ka të bëjë me stilin e shfaqjes?

- A) Zgjedhja e aktorëve
- B) Koncepti regjisorial
- C) Zgjidhja skenografike
- D) Puna në ansambël

Pyetja 24

Gjatë mizansenimit të një shfaqje në një skenë rrethore, regjisori duhet të përdorë më shumë ato kompozime hapësinore në të cilat aktorët:

- A) Janë të ulur në divane dhe karrige.
- B) Kalojnë shpesh në pozicione të ndryshme.
- C) I largohen perimetrit të rrethit skenik
- D) Rrinë në një vijë të drejtë.

Pyetja 25

Një regjisor që parapëlqen mizansena të natyrshme dhe organike, në cilin nga elementet e mëposhtme do të mbështetej më së shumti në vizatimin e shfaqjes?

- A) Në remarkat e autorit
- B) Në gjetjet e aktorëve gjatë provave
- C) Në propozimet e skenografit, kostumografit dhe projektuesve të ndriçimit
- D) Në shënimet e bëra gjatë periudhës përgatitore

Pyetja 26

“Dashuria ka forcë të shërojë.” Cila pjesë e analizës do të mund të shprehej me këtë fjali?

- A) Tema
- B) Konflikti
- C) Ideja
- D) Premisa

Pyetja 27

Kur flasim për temën, çfarë kemi parasysh?

- A) Qëndrimin ideo-artistik të autorit
- B) Problemin e shtruar në vepër
- C) Mënyrën se si është thurur historia
- D) Gjuhën e përdorur

Pyetja 28

Cili nga funksionet e mëposhtme nuk i përket specifikisht regjisorit:

- A) Zgjedhja e pjesës
- B) Ndarja e roleve
- C) Kompozimi i subjektit të dramës
- D) Interpretimi i pjesës

Pyetja 29

Si rregull, regjisori është:

- A) Thjesht një egzekutues
- B) Është tërësisht artist krijues
- C) Është një krijues, interpretues dhe trajtues i veprës së dramaturgut
- D) Thjesht një organizues

Pyetja 30

Regjisura nënkupton këto funksione me përjashtim të:

- A) Harmonizimin e gjithë mjeteve që përbëjnë shfaqjen skenike, dekorin, ndriçimin, muzikën, interpretimin e aktorëve
- B) Realizimin dhe konkretizimin e tekstit nëpërmjet vendosjes së interpretimit të aktorëve në hapësirën skenike, në një kohëzgjatje të caktuar, në prani të spektatorit.
- C) Unifikimin e elementeve të shfaqjes që çon në artikulimin e idesë së përgjithshme të saj.
- D) Garantimin e suksesit të shfaqjes dhe të shpërndarjes së saj në sa më shumë vende dhe për një jetëgjatësi sa më të madhe

Pyetja 31

Cili nga pohimet e mëposhtme e shpreh më mire qëllimin bazë që duhet të realizojë skenografia në një shfaqje teatrale:

- A) Të jetë sa më funksionale dhe t'i shërbejë qëllimit dhe shprehjes artistike të shfaqjes
- B) Të jetë sa më afër realitetit
- C) T'i qëndrojë besnike stilit të epokës kur është shkruar pjesa
- D) Të bëjë që skena të ketë një paraqitje sa më të bukur dekorative

Pyetja 32

“Mise en scene” është një togfjalësh që vjen nga frëngjishtja dhe mund të përkthehet :

- A) Vënie në skenë
- B) Rikrijim skenik
- C) Zbukurim nëpërmjet skenës
- D) Zgjidhje skenike

Pyetja 33

Mizansena është mjete kryesor shprehës:

- A) I skenografit
- B) I dramaturgut
- C) I aktorit
- D) I regjisorit

Pyetja 34

Gjatë procesit të analizës së pjesës për leximin e parë, cilit prej qëllimeve të mëposhtme duhet t'i japë përparësi regjisorit?

- A) Të mbajë shënim ritmin bazë të çdo skene
- B) Të paracakttojë se si struktura dramatike ndihmon për të shpërfaqur idenë kryesore
- C) Të bëjë një listë me kërkesat teknike të pjesës
- D) Të mbajë shënim përshtypjet e para dhe ndjenjën e përgjithshme që të ngjallë shfaqja.

## **Kapitulli 11. Dramaturgjia**

Pyetja 1

“Tragjedi” vjen nga fjala greke “tragoide” që do të thotë:

- A) Një duel për jetë a vdekje
- B) Vallja e vdekjes
- C) Kënga e cjamin
- D) Histori me fund pesimist

Pyetja 2

Kur flet për pjesët e tragjedisë të “Poetika”, Aristoteli rreshton, ndërmjet të tjerash, elementet e mëposhtme, me përjashtim të:

- A) Këngës/muzikës
- B) Gjuhës së zgjedhur/dramatike
- C) Rimës/asonancës
- D) Temës/zgjidhjes ideore

Pyetja 3

Sipas Aristotelit, cili nga elementet e mëposhtme nuk i përket tragjedisë?

- A) Karakteri/heroi tragjik
- B) Fabula/miti
- C) Spektakli/efektet skenike
- D) Metoda/analiza

Pyetja 4

Cili është personazhi kryesor në tragjedi sipas Aristotelit?

- A) Kryetari i qytetit
- B) Orakulli
- C) Heroi tragjik
- A) Kori

Pyetja 5

Çfarë gjini veprash trajton kryesisht ajo pjesë që na ka mbetur nga “Poetika” e Aristotelit?

- A) Të prozës
- B) Të dramës
- C) Të epikës
- D) Të lirikës

Pyetja 6

Kori grek:

- A) Kishte funksionin e një këshilluesi që merrte pjesë në aksion
- B) Ishte i shkëputur nga aksioni dhe shërbente për të shplodhur publikun dhe aktorët
- C) Përkrahte vetëm njërin krah të konfliktit dramatik
- D) Kryente funksion dekorativ në shfaqje

Pyetja 7

Çfarë e dallon tragjedinë nga komedia sipas “Poetikës”?

- A) Tragjedia ka një përfundim të lumtur, ndërsa komedia jo
- B) Tragjedia trajton ngjarje të rënda, ndërsa komedia është më e lehtë
- C) Tragjedia ka vetëm një akt, ndërsa komedia ka tre
- D) Tragjedia është e shkruar në prozë, ndërsa komedia në poezi

Pyetja 8

Tetralogji :

- A) Vepër dramatike që përbëhet nga tri pjesë të pavarura, të lidhura si një tërësi
- B) Vepër dramatike që përbëhet nga katër pjesë të pavarura, të lidhura si një tërësi
- C) Vepër dramatike që përbëhet nga katër pjesë që nuk kanë lidhje me njera-tjetrën
- D) Vepër dramatike që është shumë e gjatë dhe përbëhet nga tre ose katër pjesë

Pyetja 9

“Dramë” është një fjalë që vjen nga greqishtja e vjetër dhe përkthehet:

- A) Vuaj
- B) Konflikt
- C) Intrigoj
- D) Bëj

Pyetja 10

Çfarë nuk është karakteristike për satirën?

- A) Ajo përdor teknikën e komedisë, gjuhën e shkathët, ironinë dhe groteskun.
- B) Sulmon marrëzinë dhe vesin.
- C) Ajo fshikullon fenomenet shoqërore-politike negative dhe figurat e larta publike.
- D) Humori i saj është me pa të keq

Pyetja 11

Çfarë nuk është karakteristike për farsën?

- A) Qëllimi i saj është të zbavisë nëpërmjet së qeshurës
- B) Ka shumë pretendime intelektuale
- C) Mbështetet më pak te gjuha dhe te shakatë e zgjuara, sesa zhanret e tjera të komedisë
- D) Ka një lëvizja dhe ritëm të shpejtë

Pyetja 12

Çfarë është vodevili?

- A) Një lloj komedie që i afrohet farsës
- B) Farsë që përmban muzikë dhe kërcim
- C) Një lloj komedie muzikore
- D) Shfaqje varieteteje ku mbisundon muzika, skeçet komike, xhonglerimet

Pyetja 13

E qeshura në komedi krijohet më së shumti nga:

- A) Shakatë e aktorëve
- B) Nga batutat me humor
- C) Nga kundërthëniet komike
- D) Nga dëshira për të qeshur

Pyetja 14

Cilat janë zhanret kryesore dramaturgjike?

- A) Tragjedia dhe komedia
- B) Drama dhe melodrama
- C) Drama epike dhe komedia e zezë
- D) Komedia muzikore dhe opera

Pyetja 15

Cili nga elementet e mëposhtme nuk i përket kompozicionit dramaturgjik?

- A) Pika e lidhjes
- B) Zhvillimi
- C) Ekspozicioni
- D) Narracioni (rrëfimi)

Pyetja 16

I përket kompozicionit dramaturgjik:

- A) Ngjarjet
- B) Rrethanat
- C) Pika kulmore
- D) Tema

Pyetja 17

Baza kryesore ku mbështetemi për analizën e një drame është:

- A) Letërsia
- B) Psikologjia
- C) Historia e artit
- D) Antropologjia

Pyetja 18

Cila nuk është detyra e dramaturgut?

- A) Krijimi i subjektit
- B) Krijimi i karaktereve dramatike
- C) Kompozimi hapësinor
- D) Kompozimi dramaturgjik

Pyetja 19

Cili nga termat e mëposhtme tregon personazhin që është kundërshtar me personazhin kryesor?

- A) Antagonisti
- B) Protagonisti
- C) Konfliktuesi
- D) Kundërshtuesi

Pyetja 20

Me cilën pjesë mund të hapet një drame?

- A) Epilogun
- B) Prologun
- C) Nyjen lidhëse
- D) Pikën e kthesës

Pyetja 21

Cili nga elementet e mëposhtëm është tregues i stilit të teatrit epik?

- A) Një ose më shumë personazhe që i drejtohen drejtpërdrejt audiencës
- B) Një dekor realist
- C) Mishërimi i një dialogu nëpërmjet “murit të katërt imagjinar”
- D) I bazuar në ritmet e të folurit të përditshëm

Pyetja 22

Cila nga zgjedhjet e mëposhtme nuk është formë teatri?

- A) Tragjedia
- B) Komedia
- C) Aventura
- D) Farsa

Pyetja 23

Kur flasim për konvencionet dhe “rregullat e lojës” në strukturën e një pjesë dramatike, kemi parasysh kërkesat e mëposhtme, me përjashtim të:

- A) Hapësirës së kufizuar
- B) Kohës së kufizuar
- C) Forcave me karakter të fortë kundërshtues
- D) Karaktereve që i ngjajnë njerëzve në jetën e përditëshme

Pyetja 24

Etydi është:

- A) Studim mbi mënyrën se si t’i shprehim ndjenjat në mënyrë sa më efektive
- B) Njësi dramaturgjike që mbështetet mbi një veprim dhe strukturë të thjeshtë skenike
- C) Një ndodhi që nuk kërkon ndonjë kompozim të veçantë dramaturgjik
- D) Një ushtrim që na meson se si të artikulojmë sa më mire fjalën dhe xhestin

Pyetja 25

Forma teatrale e melodramës përfshin zakonisht elementet e mëposhtme, më përjashtim të:

- A) Elementeve të theksuara tragjike përzjerë me ato sentimentale
- B) Efekteve të jashtme dhe situatave të papritura artificiale
- C) Karakterit të theksuar moralizues
- D) Kërcimeve në grup

Pyetja 26

Një dramaturg, vepra e të cilit përngjason për nga forma dhe struktura me ëndrrat dhe makthet, cilën nga format dramatike të mëposhtme ka shumë të ngjarë që të përdorë?

- A) Melodramën
- B) Realizmin
- C) Ekspresionizmin
- D) Tragjedinë

Pyetja 27

Kur shkruan një pjesë, cilën nga mjetet e mëposhtme përdor kryesisht një dramaturg për të zbuluar personazhin?

- A) Strukturën e intrigës dramatike

- B) Vendin e veprimit
- C) Remarkat skenike
- D) Dialogun

Pyetja 28

Me cilin nga elementet e mëposhtme janë parë si ekuivalent bashkëkohor komeditë televizive?

- A) Teatrin epik
- B) Komedi absurde
- C) Pjeset moralizuese
- D) Komedi romantike

Pyetja 29

Dialogu në dramën ekspresioniste:

- A) I ngjan gjuhës së folur
- B) Është lirik dhe jorealit
- C) Nuk zë ndonjë rol parësor
- D) Është i thjeshtë dhe i kuptueshëm

Pyetja 30

Në përmbajtje, drama ekspresioniste ka qenë:

- A) Revolucionare
- B) Absurde
- C) Objektive
- D) E drejtpeshuar

Pyetja 31

Në dramën ekspresioniste, tablotë simbolike karakterizohen nga forma e tyre:

- A) Me lidhje të fortë organike
- B) Jo lineare
- C) Lineare
- D) Që lidhet me koncepte të caktuara kohore dhe hapësinore

Pyetja 32

Cili është objekt i pasqyrimit në dramën dhe teatrin simbolist, ekspresionist dhe surrealist?

- A) Katastrofat historike
- B) Fatkeqësitë njerëzore
- C) Frika nga bomba bërthamore
- D) Bota subjektive e heroit në veçanti dhe njeriut në përgjithësi

## Kapitulli 12. Historia e teatrit botëror dhe shqiptar

### Pyetja 1

Fjalët teatër, tragjedi, dramë, komedi, skenë, kor, karakter, mimikë, dialog, monolog, episod, muzikë:

- A) Disa e kanë prejardhjen nga greqishtja e vjetër, disa nga latinishtja
- B) Të gjitha e kanë prejardhjen nga greqishtja e vjetër
- C) Shumica e kanë prejardhjen nga greqishtja e vjetër
- D) Ndonjë prej fjalëve e ka prejardhjen nga latinishtja

### Pyetja 2

“Teatër” vjen nga fjala greke “theatron” që do të thotë:

- A) Mbledhje
- B) Vendi ku shohim
- C) Sakrifikim
- D) Ceremoni festive

### Pyetja 3

Sipas Aristotelit, teatri e ka origjinën:

- A) Nga letërsia, poezia, ditirambi
- B) Nga loja, lëvizja
- C) Nga ritualet magjike dhe fetare ku vallja luan rolin kryesor
- D) Nga vallja e shenjtë dhe loja e oborreve ose vallja pantomimike

### Pyetja 4

“Ditirambi” është:

- A) Një teori e caktuar
- B) Një himn i kënduar ose i recituar
- C) Një pjesë e shkurtër
- D) Një formë antike të shkruari

### Pyetja 5

Në cilin aspekt teatri dhe rituali nuk janë të ngjashëm?

- A) Shfrytëzojnë të njëjtat mjete: muzikën, vallen, spektaklin, maskat, kostumet
- B) Kanë të njëjtat tema: kënaqësinë, pushtetin, detyrën.
- C) Si drama ashtu dhe rituali janë pjellë e krijimtarisë së dramaturgut
- D) Rituali është një nga burimet e teatrit

### Pyetja 6

Kush është perëndia greke e teatrit?

- A) Afërdita
- B) Dionisi
- C) Apolloni
- D) Athinaja

Pyetja 7

Cili është teatri më i vjetër në botë?

- A) Teatri i Dionisit
- B) Teatri i Epidaurit
- C) Teatri i Pompeit
- D) Teatri i Romës

Pyetja 8

Si quheshin teatrot në Greqinë e lashtë?

- A) Të hapura
- B) Amfiteatro
- C) Arena
- D) Theatron

Pyetja 9

Si pjesë e cilës nga ceremonitë e mëposhtme shfaqeshin dramat më të hershme?

- A) Kurorëzimi i Perandorisë së Shenjtë Romake
- B) Konkursët me gladiatorë
- C) Festivalet e mbajtura për nder të Dionisit
- D) Mbledhjet e Kuvendit

Pyetja 10

Sipas Aristotelit, kush ishte aktori i parë që u paraqit në skenë?

- A) Euripidi
- B) Tespi
- C) Dionisi
- D) Prometeu

Pyetja 11

Cili ishte roli i korit në teatrin e Greqisë së lashtë?

- A) Ai i mikpritësi të publikut me këngë dhe lutje
- B) Mishëruesi i të gjithë personazheve kryesore të një historie
- C) Komentuesi i veprimit dramatik me një zë të vetëm kolektiv
- D) Përshkruesi i peizazhit dhe i ndryshimeve të kostumeve

Pyetja 12

Cili nuk është përfaqësues i dramaturgjisë antike greke?

- A) Seneka
- B) Eskili
- C) Sofokliu
- D) Euripidi

Pyetja 13

Kush është konsideruar “babai i tragjedisë”?

- A) Aristofani
- B) Eskili
- C) Plauti
- D) Terenci

Pyetja 14

Cilën nga tragjeditë e rreshtuara më poshtë ka marrë si shembull Aristoteli te “Poetika”?

- A) “Prometeun” e Eskilit
- B) “Edipin mbret” të Sofokliut
- C) “Eumenided” e Eskilit
- D) “Elektrën” e Sofokliut

Pyetja 15

“Edipi mbret” është shkruar nga

- A) Eskili
- B) Sofokliu
- C) Euripidi
- D) Seneka

Pyetja 16

Cila nga idetë e mëposhtme do t’i qasej më shumë tragjedisë “Edipi mbret” të Sofokliut?

- A) Njeriu është i pafuqishëm të ndalë rrotën e fatit
- B) Familja është e destinuar të shkatërrohet
- C) Njeriu është i pafuqishëm përballë Zotit
- D) E keqja që mbisundon në botë është projektim i së keqes që gjendet brenda nesh

Pyetja 17

Nëse do të vihej në skenë “Medea” e Euripidit, cili trajtim do t’i shkonte më shumë kohës sonë të lëvizjeve të mëdha demografike?

- A) Trajtimi feminist
- B) Medea në një tokë të huaj
- C) Trajtimi egzistencialist

D) Beteja e sekseve

Pyetja 18

“Janë të shumta mrekullitë në këtë botë/por mrekullia më e madhe është njeriu.”

- A) Janë vargje nga “Prometeu” i Eskilit
- B) Nga “Antigona” e Sofokliut
- C) Nga “Medea” e Euripidit
- D) Nga “Hamleti” i Shekspirit

Pyetja 19

Komedia greke u zhvillua në një kohë:

- A) Kur lulëzonte demokracia
- B) Kur sundonte oligarkia
- C) Kur njerëzve nuk u pëlqente të shikonin gjëra serioze
- D) Kur shoqëria ishte shthurur nga ana morale

Pyetja 20

Komediografi, veprat e të cilit janë inskenuar më shumë në teatrin shqiptar, është:

- A) Plauti
- B) Menandri
- C) Aristofani
- D) Terenci

Pyetja 21

Cila nga komeditë e mëposhtme trajton temën e natyrës së luftës për pushtet?

- A) “Kalorësit” (Aristofani),
- B) “Lisistrata” (Aristofani)
- C) “Menhemët” (Plauti)
- D) “Pluti” (Aristofani)

Pyetja 22

Cila nga komeditë e mëposhtme trajton temën e luftës dhe paqes?

- A) “Kalorësit” (Aristofani),
- B) “Lisistrata” (Aristofani)
- C) “Menhemët” (Plauti)
- D) “Pluti” (Aristofani)

Pyetja 23

Tek komedia “Kalorësit”, Aristofani vë në një pozitë komike edhe Demosin (popullin), i cili hiqet për hunde nga demagogët. A jeni dakord që për mosmbarvajtjen e punëve në një shoqëri apo komunitet, fajin e ka edhe populli?

- A) Fajin e kanë vetëm ata që votojnë
- B) Fajin e ka vetëm populli
- C) Fajin e kanë vetëm politikanët demagogë
- D) Çdo popull meriton qeverinë që ka

Pyetja 24

Pluti, perëndia greke që u ndan pasurinë njerëzve tek komedia me të njejtin titull e Aristofanit, është i verbër. Ky fakt do të thotë se:

- A) Në jetë duhet “të kapësh ç’ a të kapësh”
- B) Se ndarja e pasurisë në botë është e padrejtë
- C) I pasuri nuk e kupton të varfrin
- D) Pasurinë duhet ta bësh me çdo kusht

Pyetja 25

Në komedinë “Gratë në parlament” të Aristofanit, gratë marrin fuqinë në parlament dhe bëjnë reforma. Në lidhje me këtë fakt dramatik, cili do të ishte qëndrimi “politikisht korrekt”?

- A) Prania e sa më shumë grave në jetën shoqërore do ta përmirësonte atë
- B) Nuk do ta përmirësonte
- C) Edhe mund ta përmirësonte
- D) As do ta përmirësonte, as nuk do ta keqësonte

Pyetja 26

“Commedia dell’arte” :

- A) Lindi në Itali por u lëvrua edhe në Francë, Gjermani, Angli, Spanjë dhe Rusi
- B) U lëvrua vetëm në Itali
- C) Sot nuk hasim gjurmë të saj
- D) Regjisorët modernë kanë qenë indiferent ndaj saj

Pyetja 27

Çfarë është e vërtetë në lidhje me atë që quhet “Commedia dell’arte”?

- A) Nuk i kushtoj shumë rëndësi aktorëve
- B) Karakteret ishin arketipa
- C) Nuk përdorej maska
- D) Aktorët interpretonin në skenë tekste të gatshme

Pyetja 28

Veçoria kryesore e stilit “commedia dell’arte” është:

- A) Se pjesët janë gazmore
- B) Se janë shumë popullore
- C) Se personazhet e saj nuk i hasim në jetë
- D) Se mbështetet mbi improvizimin

Pyetja 29

Tek togfjalëshi “Commedia dell’arte”, kuptimi i saktë i “dell’arte” do të ishte:

- A) Që krijohet nga artista amatorë
- B) Që krijohet nga mjeshtra profesionista
- C) Që krijohet nga eruditë
- D) Që e ka prejardhjen nga antikiteti

Pyetja 30

“Commedia dell’arte” i përkiste kryesisht:

- A) Aktorit
- B) Regjisorit
- C) Autorit
- D) Xhonglerëve

Pyetja 31

Aktori i stilit “commedia dell’arte” luante zakonisht nga shfaqja në shfaqje:

- A) Vetëm një karakter
- B) Shumë karaktere
- C) Karakterin që do t’i caktohej
- D) Sipas përshtatshmërisë

Pyetja 32

Cila është tema që nuk trajtohej te “commedia dell’arte”?

- A) Politika
- B) Tradhtia
- C) Xhelozia
- D) Dashuria

Pyetja 33

Nëse do të inskenonit një pjesë sipas stilit “commedia dell’arte”, cilës do ti kushtonit më shumë rëndësi?

- A) Maskave
- B) Kostumeve
- C) Stilit specifik të lojës së aktorëve
- D) Skenografisë

Pyetja 34

Cili ishte ai zhvillim i rëndësishëm historik që solli përparimin e teatri gjatë Rilindjes?

- A) Mohimi i zhvillimit të personalitetit të njeriut
- B) Fiksimi pas dogmave dhe shtresimeve fetare
- C) Dështimi për të ndërtuar godina të reja teatroshe
- D) Shpikja e shtypshkronjës nga Gutenbergu

Pyetja 35

Rilindja e teatrit të ri evropian filloi:

- A) Në Italia
- B) Në Angli
- C) Në Spanjë
- D) Në Francë

Pyetja 36

Teatri anglez i Rilindjes e pati prejardhjen nga këta faktorë, përveçse nga:

- A) Disa pjesë të traditës mesjetare, siç ishin pjesët e mistereve dhe pjesët e moralit
- B) Drama universitare që ishte një përpjekje për të ringjallur tragjedinë greke
- C) “Commedia dell’arte”
- D) Zgjerimi i mëtejshëm i kolonive britanike nëpër botë.

Pyetja 37

Cili është teatri më i vjetër në Angli që vazhdon të përdoret edhe sot e kësaj dite?

- A) Teatri “Globe”
- B) Teatri “Blackfriars”
- C) Teatri “Rose”
- D) Teatri “Royal”

Pyetja 38

Trupat e aktorëve në teatrin e Rilindjes angleze:

- A) Financoheshin nga shteti
- B) Kishin në përbërje meshkuj dhe femra
- C) Në to, rolet e femrave i luanin burrat ose aktorët e rinj në moshë
- D) Nuk vinin pjesë të Shekspirit sepse nuk ishin shumë të suksesshme

Pyetja 39

Pse janë dinamike pjesët e Shekspirit?

- A) Sepse gjuha është shumë poetike edhe pse monologjet janë shpesh të gjata
- B) Sepse kompozicioni dramaturgjik është shumë strikt
- C) Sepse brenda një drame ka disa linja veprimi (nëintriga)
- D) Sepse pika e lidhjes fillon vonë

Pyetja 40

Në cilën periudhë i shkroi Shekspiri katër tragjeditë: “Hamleti”, “Otello”, “Mbreti Lir”, “Makbethi”?

- A) Në periudhën rinore
- B) Në periudhën e dramave historike
- C) Në periudhën e pjekurisë.
- D) Në periudhën e dramave romantike

Pyetja 41

“Jeta është një histori e trishtuar e treguar nga një idiot”, thotë një nga personazhet e Shekspirit.

Çfarë ka dashur të thotë?

- A) Se jeta është shumë e dhimbshme
- B) Se jeta është tragjikomike dhe absurde
- C) Se jeta është gazmore prandaj duhet marrë lehtë
- D) Se jeta është një ëndërr e vështirë për t’u rrëfyer

Pyetja 42

Personazhet e Shekspirit:

- A) Janë kryesisht të pasurit
- B) Kryesisht të varfrit
- C) Janë princër dhe mbretër
- D) Përfaqësojnë të gjitha shtresat shoqërore

Pyetja 43

Një kritikë letrar thotë se Shekspiri është bashkëkohësi ynë:

- A) Sepse ne jemi familjarizuar me gjuhën e tij
- B) Sepse ka shumë personazhe por tashmë ne i njohim të gjithë
- C) Se temat që shtron në vepër janë universale
- D) Sepse tani mund të zbulojmë më shumë humor nga veprat e tij

Pyetja 44

Subjektet e disa veprave të tij, Shekspiri i ka marrë nga burime të ndryshme. Çfarë nuk është e vërtetë?

- A) Që i ka marrë nga mitologjia
- B) Që disa nuk i ka ripunuar
- C) Që i ka marrë nga historia
- D) Që i ka marrë nga legjendat

Pyetja 45

Çfarë nuk është karakteristike tek veprat e Shekspirit?

- A) Koha trajtohet në mënyrë të lirshme dhe konvencionale

- B) Gjuha e pasur dhe e larmishme ndërthuret me gjuhën vulgare dhe atë prozaike
- C) Përshkrimi i scenografisë është i hollësishëm dhe po kështu kërkohet vënia skenike
- D) Ai ndërthuri komiken me tragjiken, lotët me gëzimin, butësinë me vrazhdësinë

Pyetja 46

Janë kryer hulumtime për jetën e Shekspirit dhe ekzistenca e tij është vënë në diskutim. Dysohet se veprat janë shkruar nga më shumë se një autor. Cili mund të ishte qëndrimi më i drejtë në këtë diskutim?

- A) Më duket më interesant diskutimi sesa vepra
- B) Kjo nuk ka rëndësi se vepra që ne njohim me emrin e Shekspirit është unike
- C) Të bën të dyshosh për vlerën e këtyre veprave
- D) Diskutimi për të drejtën e autorit ma rrit pëlqimin ndaj kësaj vepre

Pyetja 47

Teatri klasicist që u zhvillua kryesisht në Francë u quajt ndryshe edhe neoklasik sepse:

- A) U mbështet në idealet e antikitetit greko-romak
- B) Shpërfilli autoritetin fetar
- C) Si tragjedia, ashtu dhe komedia mund të merrej me njeriun e zakonshëm
- D) Mund të mos zbatohet rregulli i tri uniteteve

Pyetja 48

Cili nga vlerësimet për Molierin është i vërtetë:

- A) Ai nuk e shkëputi komedinë nga dogmat e ngurta të klasicizmit
- B) Ai është një nga komediografët më të mëdhenj e më popullor të teatrit botëror
- C) Komedia e Molierit nuk vlerësohet si formë serioze arti
- D) Molieri kishte marrëdhënie të mira me klerin katolik

Pyetja 49

Cili është fakti që njihet më pak në lidhje me Molierin?

- A) Që ishte aktor
- B) Që ishte teoricien i teatrit
- C) Që i drejtonte vetë shfaqjet
- D) Që ishte autor

Pyetja 50

Komedia e Molierit u ndikua në mënyrë të veçantë:

- A) Nga komedia romake
- B) Nga “commedia dell’arte”
- C) Farsa franceze
- D) Komedia e Shekspirit

Pyetja 51

E vërteta është se komeditë e Molierit:

- A) Kanë probleme strukturore
- B) Mbartin vetëm elemente komike
- C) Mbartin si elemente komike ashtu dhe dramatike
- D) Ai nuk u shkëput dot nga dogmat e ngurta të klasicizmit.

Pyetja 52

Cili është ai aspekt në krijimtarinë e Molierit ku ai i respekton parimet e klasicizmit?

- A) Mospërzjerja e zhanreve
- B) Frymëzimi nga arti antik greko-romak
- C) Frymëzimi nga e vërteta dhe e natyrshmja
- D) Respektimi i normave të mirësjelljes dhe të shijes së shëndoshë

Pyetja 53

Komeditë e Molierit mbështeten kryesisht tek:

- A) Humori i fjalës
- B) Humori i situatës
- C) Humori i karakterit
- D) Humori për humor

Pyetja 54

Emrat e personazheve të Molierit kanë hyrë në fjalorin e përditshëm. Shpesh, në vend që të themi koprac themi:

- A) Harpagon
- B) Tartuf
- C) Don Zhuan
- D) Mizantrop

Pyetja 55

Emrat e personazheve të Molierit kanë hyrë në fjalorin e përditshëm. Shpesh në vend që të themi hipokrit, themi:

- A) Harpagon
- B) Tartuf
- C) Don Zhuan
- D) Mizantrop

Pyetja 56

Emrat e personazheve të Molierit kanë hyrë në fjalorin e përditshëm. Shpesh, në vend që të themi mashtrues i grave, themi:

- A) Harpagon

- B) Tartuf
- C) Don Zhuan
- D) Mizantrop

Pyetja 57

Molieri:

- A) Nuk kishte krijuar armiqësi pavarësisht natyrës fshikulluese të veprave të tij
- B) Vdiq në skenë
- C) U varros me një ceremoni madhështore
- D) U nderua në varrim me pjesëmarrjen e Luigjt të Katërmbëdhjetë

Pyetja 58

Çfarë nuk është e vërtetë në lidhje me epokën iluministe, në shekullin XVIII?

- A) Në Francë, iluministët përmbysën doktrina të vjetra
- B) Nuk u mbështetën idetë dhe synimet e Revolucionit borgjez
- C) U lartësua njeriu dhe liria e tij
- D) Në Gjermani, u bënë përpjekje për krijimin e teatrit kombëtar

Pyetja 59

Drama “Emilia Galoti”:

- A) Është shkruar nga Volteri
- B) Nga Gotold Efraim Lesingu
- C) Nga Deni Didro
- D) Nga Pier Bomarsheja

Pyetja 60

Në traktatin e tij estetik “Dramaturgjia e Hamburgut” ku parashton idetë e tij teorike mbi dramaturginë dhe teatrin, Gotold Efraim Lesingu ngrihet kundër:

- A) Teatrit të Shekspirit
- B) Parimeve të Aristotelit
- C) Klasicizmit francez
- D) Komedisë franceze

Pyetja 61

Karlo Goldoni:

- A) Krijoi komedi të ngjashme me stilin “commedia dell’arte”
- B) E reformoi stilin “commedia dell’arte”
- C) E shpërfilli atë tërësisht
- D) Përdori maskat në komeditë e tij

Pyetja 62

Komeditë e Goldonit:

- A) Vihen në skenat e gjithë botës dhe ndiqen nga mijëra shikues
- B) Nuk pëlqehen dhe aq shumë dhe kur vihen, numri i shikuesve është i kufizuar
- C) Vihen shumë rrallë në skenë sot
- D) Tingëllojnë shumë të vjetra

Pyetja 63

Personazhi kryesor tek komedia “E zonja e bujtinës” është:

- A) Rozalina
- B) Mirandolina
- C) Beatriçe
- D) Smeraldina

Pyetja 64

“Dasma e Figaros” është shkruar nga:

- A) Molieri
- B) Goldoni
- C) Bomarsheja
- D) Lesingu

Pyetja 65

Cilën komedi ka shkruar Pier Bomarshe:

- A) “I sëmuri imagjinar”
- B) “Berberi i Seviljes”
- C) “Teatri komik”
- D) “Kumarxhinjtë”

Pyetja 66

Cili është personazhi kryesor i komedive të Bomarshe?

- A) Trufaldino
- B) Figaro
- C) Sganareli
- D) Zhyrdeni

Pyetja 67

Teatri iluminist i jepte përparsësi:

- A) Ndjenjës
- B) Arsyes
- C) Dukjes
- D) Primitives

Pyetja 68

Denis Didëroi njihet më shumë si:

- A) Dramaturg
- B) Filozof
- C) Biograf
- D) Shkrimtar

Pyetja 69

Denis Didëroi te “Paradoksi i aktorit” afirmoi:

- A) Parimet e teatrit romantik, ku mbisundon bota subjektive e heroit
- B) Parimet e artit të të paraqiturit
- C) Parimet e teatrit realist, ku mbisundon e vërteta dhe vetëm e vërteta
- D) Parimet e artit të të përjetuarit

Pyetja 70

Cili nga pohimet në lidhje me Romantizmin nuk qëndron?

- A) Është quajtur ndryshe edhe epoka e pavarësisë së njeriut
- B) Njeriu duhet ta gjejë veten duke u larguar nga instinktet e harruara primitive
- C) Heroi romantik është në kërkim të së vërtetës
- D) Në raportin ndjenjë-arsye, rolin parësor e luan ndjenja

Pyetja 71

Cili nga pohimet në lidhje me lëvizjen “Stuhi dhe vrull” nuk është i vërtetë:

- A) Kështu u quajt epoka e romantizmit në Gjermani
- B) Përfaqësuesit kryesorë të saj janë Johan Volfgang von Gëte dhe Frederik Shiler
- C) Është një nga lëvizjet më revolucionare letrare dhe artistike në Gjermani
- D) Nuk u përzje me çështje politiko-kombëtare

Pyetja 72

Cila nga veprat e mëposhtme nuk është shkruar nga Gëtja?

- A) “Fausti”
- B) “Intrigë dhe dashuri”
- C) “Ifigjenia në Tauridë”
- D) “Torquato Taso”

Pyetja 73

Cili nga pohimet në lidhje me “Faustin” e Gëtes nuk qëndron?

- A) Në qendër është personaliteti i njeriut, përkryerja intelektuale dhe morale e tij
- B) Te figura e Faustit mund të gjendet gjithë njerëzimi.
- C) Është një nga veprat më kuptimplote që ka krijuar njeriu.
- D) “Fausti” inskenohet rrallë herë dhe ata regjisorë që kanë guxuar, kanë dështuar

Pyetja 74

Cili vlerërisim është i gabuar?

- A) Gëtja ishte një figurë shumë e rëndësishme e teatrit
- B) Ai ka qenë në krye të Teatrit të Vajmarit
- C) Ai kishte ide jo praktike në lidhje me regjinë, aktrimin dhe dramaturgjinë
- D) Ai ka shkruar edhe një traktat për aktorët

Pyetja 75

Cili pohim në lidhje me Frederik Shilerin nuk qëndron?

- A) U frymëzua nga idealet e lirisë
- B) U bë një nga udhëheqësit kryesorë të lëvizjes “Stuhi dhe vrull”
- C) Shton ide kombëtare që kanë të bëjnë me bashkimin e kombit gjerman
- D) Problemin e lirisë nuk e shtron në planin politik e shoqëror

Pyetja 76

Idetë e Gëtes tek “Fausti” janë kryesisht:

- A) Pesimiste
- B) Universale
- C) Optimiste
- D) Djallëzore

Pyetja 77

Cili pohim në lidhje me personazhin e Faustit është gjysëm i vërtetë:

- A) Përmbledh historinë e njerëzimit në kërkim të diturisë
- B) Personifikon shpirtin e ri, bashkëkohor
- C) Afirmon forcat krijuese të njeriut
- D) I intereson vetëm ana e ndritshme e botës

Pyetja 78

Çfarë nuk është e vërtetë në lidhje me faktorët që kushtëzuan lindjen e teatrit modern?

- A) Zbulimet në fushën shkencore dhe psikologjike ndryshuan këndvështrimin heroik dhe romantik të botës
- B) Dominoi gjithmonë e më shumë shtresa e mesme
- C) Mbisunduan çështjet që shqetësonin njeriun e zakonshëm dhe mjedisin e tij
- D) Mbisundonte prapambetja në fushën e teknologjisë dhe telekomunikacionit

Pyetja 79

Është konsideruar si babai i letërsisë dhe dramaturgjisë modern ruse:

- A) Aleksandër Pushkin
- B) Nikollaj Vasiljeviç Gogol
- C) Aleksandër Ostrovski

D) Anton Pavllloviç Çehov

Pyetja 80

Komedia e njohur “Revizori” është shkruar nga:

- A) Anton Pavllloviç Çehov
- B) Nikollaj Vasiljeviç Gogol
- C) Maksim Gorki
- D) Aleksandër Gribojedov

Pyetja 81

Çfarë lloj teatrit u përqendrua në realitetin social dhe moral në shekullin XIX?

- A) Teatri absurd
- B) Teatri realist
- C) Teatri ekzistencialist
- D) Teatri romantik

Pyetja 82

Kush është autor i veprës teatrore “Shtëpi kukulle”?

- A) August Strindberg
- B) Tenesi Uilliams
- C) Henrik Ibsen
- D) Juxhin O’Nill

Pyetja 83

Kush është quajtur “babai i teatrit modern”?

- A) Shekspiri
- B) Henrik Ibseni
- C) Anton Çehovi
- D) Artur Milleri

Pyetja 84

Teatri realist i fundit të shekullit XIX dhe i fillimit të shekullit XX filloi si eksperiment për ta bërë teatrin më të dobishëm për shoqërinë, në një kohë kur:

- A) Mbisundonin pjesët e Shekspirit
- B) Mbisundonin forma të lehta për të zbavitur spektatorin
- C) Teatri ishte mbingopur duke trajtuar probleme serioze
- D) Teatri merrte përsipër të trajtonte probleme që nuk i takonin

Pyetja 85

Cila nuk është dramë e Ibsenit?

- A) “Shtyllat e shoqërisë”
- B) “Shtëpia e kukullës”
- C) “Hijet”
- D) “Babai”

Pyetja 86

Pjesët e Ibsenit mbartin edhe elemente:

- A) Simboliste
- B) Horrori
- C) Surrealiste
- D) Ekspresioniste

Pyetja 87

Tek “Shtëpi kukulle”, titulli është përcaktim simbolik që nënkupton:

- A) Një shtëpi ku ka shumë fëmijë dhe pak të rritur
- B) Një shtëpi të varfër por të lumtur
- C) Që është teatër marjonetash
- D) Se kjo nuk është një familje e vërtetë por butaforike

Pyetja 88

Ibseni e shkroi dramën “Hijet”:

- A) Sipas një historie të vërtetë që kishte lexuar
- B) Mbështetur mbi një kronikë të kohës
- C) Pas suksesit dhe skandalit të dramës “Shtëpi kukulle”
- D) Pa ndonjë shtysë të fshehtë

Pyetja 89

Shpesh dramat e Ibsenit etiketohen si:

- A) Drama dokumentare
- B) Drama moralizuese
- C) Drama debat
- D) Forume politike

Pyetja 90

August Strindbergu:

- A) Ishte gjerman
- B) Ishte suedez
- C) Ishte norvegjez
- D) Ishte zvecerian

Pyetja 91

August Strindbergu njihet më shumë si:

- A) Eseist
- B) Dramaturg
- C) Shkrimtar
- D) Piktur

Pyetja 92

“Zonjusha Zhuli” e Strindbergut është:

- A) Një dramë e shkruar në stilin e Ibsenit
- B) E shkruar në stilin ekspresionist
- C) Në stilin epik
- D) Dramë dokumentare

Pyetja 93

Cila nga dramat e mëposhtme nuk i përket Strindbergut?

- A) “Babai”
- B) “Vallja e vdekjes”
- C) “Jun Gabriel Borkman”
- D) “Rruga për Damask”

Pyetja 94

Çfarë ka të përbashkët midis Henrik Ibsenit dhe August Strindbergut?

- A) Të dy kanë lëvruar dramën ekspresioniste
- B) Të dy janë marrë me problemin e familjes në dramat e tyre
- C) Të dy kanë shkruar drama debat
- D) Të dy i kanë marrë temat e dramave të tyre nga histori vetjake

Pyetja 95

August Strindberg njihet si dramaturgu që ka krijuar:

- A) Vetëm drama në stilin natyralist
- B) Vetëm drama në stilin ekspresionist
- C) Si drama natyraliste, ashtu edhe ekspresioniste
- D) Drama që kundërshtonin tendencën e kohës

Pyetja 96

Cili nga pohimet që vijojnë i përket August Strindbergut?

- A) Në dramat e tij ekspresioniste, ai imitonte formën në dukje të palidhur të ëndrrës
- B) Pjesët e tij shtronin më shumë probleme shoqërore sesa individuale
- C) Kishte interes më shumë për probleme antropologjike
- D) Pjesët e tij kanë më shumë karakter feminist sesa maskulist

Pyetja 97

Krijimtaria e Strindbergut u zhvillua:

- A) Pa shumë dilema estetike dhe egzistenciale
- B) Në një rrugë plot zigzage dhe me mjaft kontradikta të brendshme
- C) Në një trajektore që kishte vetëm rritje
- D) Nën frymëzimin e aventurave të dashurisë me gratë

Pyetja 98

Sipas teorisë së natyralizmit të Emil Zolasë, drama duhej të mbështetej në faktorët që vijnë, përveç:

- A) Shkaqeve të sëmundjeve të shoqërisë
- B) Ekspozimit të infeksionit social me shëmtinë e tij
- C) Trajtimin të qenieve njerëzore si produkte të trashëgimisë dhe të mjedisit
- D) Fasadës dhe zburimit të jetës dhe lustrimit të realitetit

Pyetja 99

Historianëve të teatrit në përgjithësi u pëlqen të thonë se:

- A) Regjizura nuk ka ekzistuar para shekullit XIX
- B) Ka ekzistuar si art më vete që nga antikiteti
- C) Që në kohën e Shekspirit flitej për regjiturën e shfaqjeve të tij
- D) Molieri punësonte një regjisor që harmonizonte elementet komplekse skenike

Pyetja 100

Konsiderohet si krijuesi i regjiturës moderne franceze, me "Teatrin e lirë" të tij:

- A) Stanislavski
- B) Otto Brahma
- C) Adolf Apia
- D) Andre Antuani

Pyetja 101

Në cilin nga aspektet e mëposhtme të teatrit dha kontributin më të madh Adolf Apia?

- A) Aktrim
- B) Grim
- C) Kostume
- D) Projektimi i hapësirës skenike

Pyetja 102

Anton Pavlloviç Çehovi:

- A) Ka shkruar vetëm prozë
- B) Ka shkruar vetëm drama
- C) Është i shquar vetëm në dramaturgji

D) Është i shquar edhe në dramaturgji, edhe në prozë

Pyetja 103

Pjesët e Çehovit janë kryesisht:

- A) Komedi romantike
- B) Drama serioze
- C) Tragjikomedi
- D) Farsa lirike

Pyetja 104

Cilën nga pjesët e mëposhme nuk e ka shkruar Anton Pavloviç Çehovi?

- A) “Xhaxha Vanja”
- B) “Ylli pa emër”
- C) “Tri motrat”
- D) “Kopshti i qershive”

Pyetja 105

“Pulëbardha” e Anton Pavloviç Çehovit:

- A) Kishte sukses të menjëhershëm
- B) Është shkruar në fund të krijimtarisë së tij
- C) Nuk ka njohur sukses edhe kur Çehovi bashkëpunoi me Stanislavskin
- D) Shënoi fillimin e pjekurisë së Çehovit si ndjekës i realizmit dhe i dramës lirike

Pyetja 106

Tema kryesore e dramave të Çehovit është:

- A) Natyra konvencionale e martesës
- B) Zhgënjimi dhe karakteri tragjikomik i egzistencës njerëzore
- C) Problematika e fshatit rus të shekullit të XIX
- D) Konflikti midis brezave

Pyetja 107

Kur flasim për stilin çehovian kemi parasysh një karakteristikë që lidhet me:

- A) Natyrën e brishtë të karakterit rus
- B) Botën e brendshme të karaktereve
- C) Natyrën groteske të karaktereve
- D) Me kompleksin e inferioritetit të karaktereve

Pyetja 108

Edhe pse pjesët e Çehovit janë realiste, ato kanë edhe elemente të shumta:

- A) Surrealiste

- B) Symboliste
- C) Konstruktiviste
- D) Të komedisë së zezë

Pyetja 109

Parimi kryesor i teatrit modern ishte:

- A) Pasqyrimi i anës më të bukur të jetës
- B) E vërteta dhe vetëm e vërteta
- C) Pasqyrimi i anës më të shëmtuar të saj
- D) Pasqyrimi formalist i fenomeneve

Pyetja 110

Tek pjesa “Gjashtë personazhe kërkojnë autor”, Pirandelo ka marrë në shqyrtim sidomos:

- A) Problemet që lidhen me shkrimin e dramës në teatër
- B) Teatrin si simbol të temave universale-filozofike që shqetësonin Pirandelon vetë
- C) Eksperimentin në teatër
- D) Dramën specifike të gjashtë personazheve

Pyetja 111

Teatri i Pirandelos quhet ndryshe edhe metateatër, sepse:

- A) Shqyrton diçka që qëndron përtej teatrit
- B) Pjesë të subjektit ka vetë teatrin
- C) Sepse ajo që trajton nuk ka asnjë lidhje me teatrin
- D) Sepse pjesët i shkruante njëherë në prozë dhe pastaj i kthente në dramë

Pyetja 112

Për cilat nga temat që vijojnë nuk interesoheshin shumë veprat e Pirandelos?

- A) Për temën e pamundësisë së komunikimit të së vërtetës objektive
- B) Për temat sentimentale dhe sociale
- C) Për temën e thelbit dhe dukjes
- D) Për atë të iluzionit dhe realitetit

Pyetja 113

Në traditën e cilit teatër u mbështet shumë Pirandelo në shkrimin e dramave të tij?

- A) Teatrit klasik
- B) Teatrit të Molierit
- C) “Commedia dell’arte”
- D) Teatrit letrar

Pyetja 114

Artur Mileri ka pasur shumë ndikim në disa vepra të tij nga:

- A) Beketi
- B) Çehovi
- C) Ibseni
- D) Franc Kafka

Pyetja 115

Cili prej këtyre dramaturgëve është autori i dramës "Udhëtim i gjatë drejt natës"?

- A) Harold Pinter
- B) David Mamet
- C) Juxhin O'Nill
- D) Artur Miller

Pyetja 116

Veprat e Artur Milerit kanë karakter të theksuar:

- A) Impresionist
- B) Avangardist
- C) Realist
- D) Simbolist

Pyetja 117

Cila prej këtyre dramave të rëndësishme të shekullit XX nuk janë vënë në skenën e teatrit shqiptar?

- A) "Sonte do të luajmë pa tekst" dhe "Gjashtë personazhe kërkojnë autor" të Pirandelos,
- B) "Vdekja e komisionerit" dhe "Pamje nga ura" të Artur Milerit
- C) "Henriku IV" i Pirandelos dhe "Midis dy të hënave" të Milerit
- D) "Udhëtim i gjatë drejt natës" e O, Nilit dhe "Shtëpia e Bernarda Albës" e Lorkës

Pyetja 118

Cili prej këtyre dramaturgëve ka rimarrë temën e "Antigonës"?

- A) Zhan Zhene
- B) Zhan Anui
- C) Juxhin O'Nill
- D) Luixhi Pirandello

Pyetja 119

Cili nga pohimet nuk është i vërtetë?

- A) Brehti konsiderohet si personaliteti më i rëndësishëm i teatrit gjerman të sh. XX.
- B) Veprimtaria e tij u shtri në një periudhë tridhjetëvjeçare, që pas Luftës së Parë Botërore, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj
- C) Ndikimi i tij ishte relativisht i pakët për shkak të bindjeve të tija të majta

D) Ai është një nga personalitetet më me ndikim në gjithë teatrin e shekullit të XX

Pyetja 120

Brehti njihet:

- A) Si dramaturg por jo si regjisor
- B) Vetëm si regjisor
- C) Vetëm si poet
- D) Edhe si poet, edhe si dramaturg, edhe si regjisor

Pyetja 121

Brehti:

- A) Ka qenë edhe poet
- B) Nuk ka shkruar poezi
- C) Ka shkruar po nuk njihet si i tillë
- D) Ka qenë i rëndësishëm edhe si poet

Pyetja 122

Cila vepër dramatike nuk i përket Brehtit?

- A) “Nëna Kurajë dhe fëmijët e saj”
- B) “Bidermani dhe zjarrvënësit”
- C) “Jeta e Galileo Galileit”.
- D) “Rrethi i Kaukazit”

Pyetja 123

Teatri i Brehtit është:

- A) Teatri i vrazhdësisë
- B) Teatër politik
- C) Teatri i iluzionit
- D) Teatër konstruktivist

Pyetja 124

Një kritik thotë se Nëna Kurajë, personazhi kryesor i dramës “Nëna Kurajë dhe fëmijët e saj” e Brehtit, u bë tregtare sepse ishte nënë, por nuk mund të ishte nënë sepse ishte tregtare. Çfarë ka dashur të thotë ai?

- A) Se të qenit nënë të pengon të pasurohesh
- B) Se kapitalizmi e tjetëron njeriun
- C) Se të qenit tregtare për atë si grua është diçka që nuk mund t’i mohohet
- D) Se, sidoqoftë, kujdesi për fëmijët e tjetëron atë si person

Pyetja 125

Cili prej personaliteteve të mëdhenj të teatrit evropian nuk ka pasur ndikim nga Brehti?

- A) Piter Bruk
- B) Antonin Artó
- C) Dario Fo
- D) Fridrih Dyrenmat

Pyetja 126

Karakteristikë për nobelistin Dario Fo është se ai:

- A) Bashkoi stilin “commedia dell’arte” me stilin e teatrit epik
- B) E parodizoi teatrin epik e politik
- C) Ishte kundër kthimit të teatrit në një tribunë mesazhesh shoqërore dhe politike
- D) I shkruante pjesët por nuk luante vetë, edhe pse ishte aktor

Pyetja 127

Dario Fo ka shkruar pjesën:

- A) “Vizita e inspektorit”
- B) “Vdekja e anarkistit,,
- C) “Vallja e vdekjes,,
- D) “Përvjetori i ditëlindjes,,

Pyetja 128

Kush e ka shkruar pjesën “Vizita e damës plakë,,?

- A) Bertolt Breht
- B) Fridrich Dyrenmat
- C) Maks Frish
- D) Dario Fo

Pyetja 129

Poeti frankofon belg Moris Meterlinku është një nga përfaqësuesit kryesorë të:

- A) Perspektivizmit
- B) Simbolizmit
- C) Kubizmit
- D) Primitivizmit

Pyetja 130

Gjuha në veprat e Meterlinkut i ngjan shumë:

- A) Gjuhës së folur
- B) Gjuhës abstrakte
- C) Gjuhës poetike simboliste
- D) Gjuhës së përroit psiqik

Pyetja 131

Temat kryesore të veprave të Meterlinkut janë ato që lidhen me:

- A) Raportin e formës së veprës dramaturgjike dhe përmbajtjes së saj
- B) Misterin e egzistencës njerëzore
- C) Raportin e njeriut me pushtetin
- D) Botën e fëmijëve

Pyetja 132

Ekspresionizmi ishte një lëvizje që u zhvillua dhe lulëzoi kryesisht në:

- A) Gjermani fill pas Luftës së Parë Botërore
- B) Francë në periudhën midis dy luftërave botërore
- C) Rusi fill pas Revolucionit të Teatorit
- D) Në Angli pas Luftës së Parë Botërore

Pyetja 133

Ekspresionizmi u karakterizua kryesisht nga:

- A) Kërkimi i shkaqeve politiko-shoqërore të luftës
- B) Përpjekja për të dramatizuar gjendjet subjektive me anë të imazheve tronditëse
- C) Kërkimi i një gjuhe që i përafrohej tingujve dhe muzikës
- D) Dokumentimi i katastrofave njerëzore me anë të videos

Pyetja 134

Në teatrin e shekullit XX, lëvizje të tilla si ekspresionizmi, surrealizmi, absurdizmi dhe teoritë e Antonin Artósë dhe Grotovskit, konsiderohen si:

- A) Moderne
- B) Primitiviste
- C) Avangardiste
- D) Antiteatër

Pyetja 135

Alfred Zharri ishte një nga përfaqësuesit dhe pararendësit:

- A) E teatri të absurdit
- B) E dramës debat
- C) E teatrit epik
- D) E dramës dokumentare

Pyetja 136

“Ybyja mbret” e Alfred Zharisë është një vepër:

- A) Që bën humor shpesh të pakuptueshëm
- B) Një vlerësim për “Makbethin” e Shekspirit
- C) Që ka një atmosferë romantike

D) Që ka ndikuar shumë teatrin e absurdit

Pyetja 137

Patafizika:

- A) Është një filozofi e shkencës
- B) Synon ta parodizojë shkencën
- C) Është shkenca e zgjidhjeve imagjinare
- D) Është shpikur nga Alfred Zharri

Pyetja 138

Kur flasim për surrealizmin kemi parasysh:

- A) Një tentativë për tu shkëputur nga realiteti
- B) Një realitet më të thellë sesa realiteti që paraqet mendja racionale dhe e vetëdijshme
- C) Një stad më i ulët se realizmi
- D) Një arratisje nga problemet e vërteta njerëzore

Pyetja 139

Pjesët dramatike të Zhan Pol Sartrit janë:

- A) Absurde
- B) Ilustrim i filozofisë së tij ekzistencialiste
- C) Të shkruara në stil jorealit
- D) Janë alternative

Pyetja 140

Cilën nga pjesët e mëposhtme dramatike nuk e ka shkruar Albert Kamyja?

- A) “Kaligula”
- B) “Mosmarrëveshja”
- C) “Të drejtët”
- D) “Me dyer të mbyllura”

Pyetja 141

Me cilin prej këtyre krijuesve në historinë e teatrit modern lidhet termi “biomekanika”?

- A) Antonin Artó
- B) Konstantin Stanislavski
- C) Vsevolod Mejerholdi
- D) Mihail Çehovi

Pyetja 142

Teatri i absurdit është ndikuar më shumë nga:

- A) Surrealizmi

- B) Teatralizmi
- C) Teatri epik
- D) Teatri i rrugës

Pyetja 143

Cili është kuptimi më i drejtë i togëfjalëshit “teatri i absurdit”?

- A) Që është një teatër që nuk kuptohet lehtë dhe të lë shijen e thujtëzimit
- B) Është teatër që mbështetet në një filozofi të absurdit
- C) Është një term i sajuar
- D) Është teatër absurd

Pyetja 144

Cilën nga veprat e mëposhtme nuk e ka shkruar Jonesko?

- A) “Karriket,,
- B) “Këngëtarja tullace,,
- C) “Makbett,,
- D) “Fundi i lojës,,

Pyetja 145

Cili nga dramaturgët e mëposhtëm është autori i dramës “Kush ka frikë nga Virxhinia Ulf”?

- A) Tenesi Uilliams
- B) Artur Miller
- C) Eduard Olbi
- D) Sem Shepard

Pyetja 146

Me cilin personalitet lidhet ideja e njohur si “teatri i mizorisë”?

- A) Samuel Beket
- B) Euzhen Jonesko
- C) Piter Sheffer
- D) Antonin Artó

Pyetja 147

Cili nga dramaturgët e mëposhtëm është i njohur për krijimet e tij në “teatrin e absurdit”?

- A) Samuel Beket
- B) Tenesi Uilliams
- C) Artur Miller
- D) August Strindberg

Pyetja 148

Vladimiri dhe Estragoni harxhuan kohën gjatë një pjese të tërë duke pritur:

- A) Pocon
- B) Ioneskon
- C) Godonë
- D) Beketin

Pyetja 149

Cila nga temat e mëposhtme do t'i qasej më shumë veprës “Duke pritur Godonë”?

- A) Kalimi i kohës kot
- B) Zhgënjimi dhe kotësia e egzistencës
- C) Mosbesimi në Zot
- D) Tema e vetvrasjes

Pyetja 150

Cili nga dramaturgët e mëposhtëm është autori i pjesës “Karriket”?

- A) Zhan-Paul Sartër
- B) Euzhen Ionesko
- C) Luixhi Pirandelo
- D) Antonin Artó

Pyetja 151

Cili prej këtyre regjisorëve është i njohur për stilin e tij avangardist në skenën teatrale dhe për kontributin në “teatrin e mizorisë”?

- A) Bertolt Brehti
- B) Zherzhi Grotovski
- C) Piter Bruku
- D) Robert Uilsoni

Pyetja 152

Cili prej këtyre dramaturgëve është i njohur për eksplorimin e temave të dhunës dhe të abuzimit në veprat e tij?

- A) Sarah Kein
- B) Karil Çurçill
- C) Eduard Olbi
- D) David Mamet

Pyetja 153

Me cilin nga stilet apo lëvizjet teatrale të mëposhtme janë më së shpeshti të lidhura dramet e Sarah Keinit?

- A) Natyralizmin

- B) “In-Yer-Face Theatre”
- C) Teatrin e absurdit
- D) Teatrin e klasës punëtore

Pyetja 154

“Teatri i imazheve” i Robert Uilsonit:

- A) Përdor vetëm muzikë dhe kërcim
- B) Përqendrohet në vizualizimin e ideve përmes imazheve të fuqishme
- C) Përdor vetëm pantomimë
- D) Përqendrohet vetëm në dialog

Pyetja 155

Cili teatër nuk gjendet në Shqipëri?

- A) Teatri i Butrintit
- B) Teatri i Bylisit
- C) Teatri i Milos
- D) Teatri i Finiqit

Pyetja 156

Sa vende ka Teatri i Butrintit?

- A) Rreth 500
- B) Rreth 1000
- C) Rreth 2000
- D) Rreth 3000

Pyetja 157

Me komedinë “Pas Vdekjes”, Çajupi i hapi rrugën:

- A) Komedisë zakonore
- B) Komedisë politike
- C) Komedisë pastorale
- D) Farsës së zezë

Pyetja 158

Cili nuk është personazh i komedisë “Pas Vdekjes”?

- A) Zeneli
- B) Lulushja
- C) Vangjeli
- D) Doktor Adhamudhi

Pyetja 159

Përmes doktor Adhamudhit, Çajupi ka demaskuar:

- A) Tipin e politikanit sharlatan që hiqet si atdhetar
- B) Doktorët e paaftë që grabisin njerëzinë
- C) Grekofilët që përbuzin atdheun e yre
- D) Ziliqarët dhe keqëdashësit

Pyetja 160

Zeneli te komedia “Pas Vdekjes” është tipi:

- A) Që përfaqëson mençurinë dhe humorin popullor
- B) Finokërinë e shtresave të varfra
- C) Shpirtin praktik të fshatarit dinak
- D) Servilin që bën gjithçka për pesë para

Pyetja 161

Komedia “Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr” është shkruar:

- A) Në prozë
- B) Në vargje me rimë
- C) Në formë bejtesh
- D) Në varg të bardhë

Pyetja 162

Komedia “Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr”?

- A) Është një komedi me humor të tejkaluar
- B) Komedi me një gjuhë të pasur, me tipare realiste
- C) Farsë pa shumë peshë ideore
- D) Mbart mjete që tani tingëllojnë të vjetëruara

Pyetja 163

Fan Noli njihet si përkthyes i shumë prej kryeveprave të dramaturgjisë botërore. Ai solli gjithashtu në shqip dy vepra të Ibsenit:

- A) “Shtëpi kukulle” dhe “Heda Gabler”
- B) “Zonja Ingra e Ostrotit” dhe “Armiku i popullit”
- C) “Hijet” dhe “Rosa e egër”
- D) “Jun Gabriel Borkman” dhe “Per Gynt”

Pyetja 164

Fan Noli ka dhënë një kontribut në analizën dramaturgjike:

- A) Sepse na ka lënë libra të vyer në lidhje me të
- B) Nëpërmjet parathënieve të shkëlqyera të dramave që ka përkthyer
- C) Sepse në poezitë e tij ka shumë referenca dramaturgjike

D) Ka shkruar edhe një traktat kritikë

Pyetja 165

Cila prej veprave të mëposhtme të Fan Nolit është dramë?

- A) Bethoveni dhe Revolucioni Francez
- B) Izraelitë dhe filistinë
- C) Historia e Skënderbeut
- D) Marshi i Barabajt

Pyetja 166

Cilën nga këto vepra nga Shekspiri nuk ka përkthyer Fan Noli?

- A) Tragjedinë “Otello”
- B) Tragjedinë “Makbethi”
- C) Tragjedinë “Hamleti”
- D) Tragjedinë “Mbreti Lir”

Pyetja 167

“Israilitë dhe Filistinë” e Nolit ia vlen të veçohet:

- A) Sepse ajo e merr subjektin nga Bibla
- B) Sepse është në formën e një debati filozofik
- C) Sepse ajo bën përpjekje për të trajtuar problemet politike të kohës
- D) Sepse ajo heq dorë nga sentimentalizmat që karakterizojnë krijimet dramaturgjike të kohës

Pyetja 168

Cila është drama e parë e shkruar në shqip?

- A) “Besa” e Sami Frashërit
- B) “Emira” e Françesk Anton Santorit
- C) “Numidët” e Jeronim De Radës
- D) Komedia “Biri i Çifutit”, e Pashk Babit

Pyetja 169

Sokrat Mio:

- A) Vuri themelet e regjisorës shqiptare
- B) Shkroi drama me përmbajtje patriotike
- C) Ka dhënë kontribut në fushën e operas shqiptare
- D) Ka kryer konservatorin e muzikës në Romë

Pyetja 170

Çfarë nuk është e vërtetë në lidhje me Aleksandër Moisiun?

- A) Ka lindur në Trieste
- B) Me nënë arbërshe
- C) Me baba shqiptar
- D) Ka jetuar shumë vite në Shqipëri

Pyetja 171

Pavarësisht se tingëllon e pabesueshme, Aleksandër Moisiu e luajti 1400 herë:

- A) Hamletin (“Hamleti” e Shekspirit)
- B) Fedjan (“Kufoma e gjallë” e Tolstoit)
- C) Jedemanin (“Jederman” të Hugo von Hofmannsthal)
- D) Faustin (“Fausti” nga Göte)

Pyetja 172

Aleksandër Moisiu ka bashkëpunuar me shumë sukses në mënyrë të veçantë me:

- A) Maks Rainhardin
- B) Bertolt Brechtin
- C) Ervin Piskatorin
- D) Luixhi Pirandelo

Pyetja 173

Kristo Floqi ka shkruar kryesisht:

- A) Drama
- B) Komedi me një akt
- C) Tregime
- D) Përkthime

Pyetja 174

Komedinë “Vllazëri e interes”:

- A) E ka shkruar Çajupi
- B) Foqion Postoli
- C) Kristo Floqi
- D) Spiro Çomora

Pyetja 175

Filmi “Përrallë nga e kaluara” është një realizim shumë i suksesshëm, mbështetur në komedinë e traditës:

- A) “Katërmbëdhjetë vjeç dhëndërr” të Çajupit
- B) “Martesa e avokatit” të Foqion Postolit
- C) “Pas vdekjes” të Çajupit
- D) “Zi e më zi” Të Kristo Floqit

Pyetja 176

Teatri i parë profesionist në Shqipëri u themelua në vitin:

- A) 1930
- B) 1945
- C) 1912
- D) 1939

Pyetja 177

Teatri i parë profesionist u quajt:

- A) Teatri Kombëtar
- B) Teatri Popullor
- C) Teatri i Shtetit
- D) Teatri Profesionist

Pyetja 178

Shkolla e Lartë Dramatike “Aleksandër Moisiu” në Tiranë u themeluar në vitin:

- A) 1930
- B) 1959
- C) 1980
- D) 1945

Pyetja 179

Teatri i parë profesionist u vendos në:

- A) Korçë
- B) Shkodër
- C) Tiranë
- D) Durrës

Pyetja 180

Metoda e realizmit socialist që u aplikua në art dhe në kulturë pas viteve '70:

- A) I dha teatrit më shumë hapësirë
- B) E popullarizoi teatrin
- C) Vuri kufizime ideo-estetike për artistët e teatrit
- D) Krjoi mundësi të reja shprehëse për artistët

Pyetja 181

Realizmi socialist e vështronte teatrin:

- A) Si veprimtari që synon të bukurën dhe kënaqësinë
- B) Si mjetin e edukimit të njerëzve sipas ideologjisë së partisë
- C) Si mjet që nxit dashurinë midis njerëzve
- D) Si mjet që shpërfill luftën e klasave

Pyetja 182

Karakteristika e teatrit të komanduar ka qenë:

- A) Skematizmi
- B) Liria e shprehjes
- C) Frymëzimi
- D) Toleranca

Pyetja 183

“Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i Kadaresë është inskenuar dhe ekranizuar disa herë me sukses, në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë. Cili pohim është më i saktë?

- A) Gjeneralin, nëpër vite, e ka luajtur Sandër Prosi, Bujar Lako, Bajrush Mjaku
- B) Gjeneralin, nëpër vite, e ka luajtur vetëm Sandër Prosi në teatër dhe Bujar Lako në film
- C) Gjeneralin, në film, e ka luajtur vetëm Marcelo Mastroiani
- D) Gjeneralin, nëpër vite, e kanë luajtur Sandër Prosi dhe Bajrush Mjaku në teatër dhe Bujar Lako dhe Marcelo Mastroiani në film

Pyetja 184

Janë disa regjisorë që kanë inskenuar dhe ekranizuar me sukses “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”. Në lidhje me këtë fakt, cili pohim është më i plotë?

- A) Pirro Mani dhe Dhimitër Anagnosti e kanë realizuar, përkatësisht në teatër dhe film
- B) Pirro Mani e ka realizuar në teatër, Dhimitër Anagnosti dhe Vladimir Prifti, përkatësisht në film dhe në televizion
- C) E kanë realizuar Dino Mustafiç dhe Pirro Mani në teatër dhe Dhimitër Anagnosti, Luciano Tovioli, Vladimir Prifti, përkatësisht në film dhe në televizion
- D) Luciano Tovioli dhe Dhimitër Anagnosti në film

Pyetja 185

Një nga veprat e Bertolt Brehtit është vënë me shumë sukses në Teatrin kombëtar, me regji të Piro Manit dhe rolin kryesor e luante Kadri Roshi. Cila prej tyre?

- A) “Galileo Galileu”
- B) “Arturo Ui”
- C) “Opera për tri groshë”
- D) “Nëna Kurajë dhe fëmijët e saj”

Pyetja 186

Cili prej dramaturgëve bashkëkohorë është vënë më shpesh kohët e fundit në skenën shqiptare?

- A) Sarah Kein
- B) Eduard Olbi
- C) David Mamet
- D) Martin Mekdouna

Pyetja 187

Komedinë “Karnavalet e Korçës” e ka shkruajtur:

- A) Spiro Çomora
- A) Ruzhdi Pulaha
- B) Kol Jakova
- C) Dritëro Agolli

Pyetja 188

Cila nga këto vepra të Dritëro Agollit është komedi?

- A) “Trëndafili në gotë”
- B) “Arka e djallit”
- C) “Fytyra e dytë”
- D) “Njeriu i mirë”

Pyetja 189

Cila nga këto vepra të Ismail Kadaresë është dramë?

- A) “Stinë e mërzitshme në Olimp”
- B) “Nata me hënë”
- C) “Prilli i thyer”
- D) “Pallati i ëndrrave”

Pyetja 190

Cila nga këto vepra të Ismail Kadaresë nuk është dramaturgizuar?

- A) “Kush e solli Doruntinën”
- B) “Dimri i vetmisë së madhe”
- C) “Nata me hënë”
- D) “Darka e gabuar”

Pyetja 191

Cilën komedi apo poemë dramatike nuk e ka shkruar Gjergj Fishta?

- A) “Gomari i Baba Tasit”,
- B) “Martesa e avokatit”
- C) “Juda Makabe”,
- D) “Shqyptari i qytetëruem”

Pyetja 192

Cila nga veprat e mëposhtme të teatrit të absurdit nuk është inskenuar ende në teatrin shqiptar?

- A) “Në pritje të Godosë”, e Beketit,
- B) “Këngëtarja tullace” nga Jonesko
- C) “Fando dhe Lis” nga Arrabal
- D) “Ybyja mbret” Alfred Zharri

Pyetja 193

Cili nga aktorët e Teatrit Kombëtar ka luajtur rolin e Hamletit?

- A) Sulejman Pitarka
- B) Agim Qirjaqi
- C) Naim Frashëri
- D) Ndrek Luca

Pyetja 194

Cili nga aktorët shqiptar ka luajtur personazhin e Mbretit Lir?

- A) Robert Ndrenika
- B) Viktor Zhusti
- C) Bujar Asqeriu
- D) Vangjush Furxhiu

Pyetja 195

Cili nuk është regjisor nga personalitetet e radhitura më poshtë?

- A) Gëzim Kame
- B) Serafin Fanku
- C) Yllka Mujo
- D) Drita Agolli

Pyetja 196

Cili nga emrat e regjisorëve të përmendur më poshtë ka qenë i persekutuar politikisht?

- A) Fatos Haxhiraj
- B) Pandi Stillu
- C) Kujtim Spahivogli
- D) Dhimitër Pecani

Pyetja 197

Regjia e Pirro Manit është mbi të gjitha e veçantë:

- A) Sepse mori përsipër të vërë në skenë kryevepra botërore
- B) Sepse solli bagazhin e një shkolle teatri nga më të mirat në botë
- C) Sepse arriti të harmonizojë elemente të talentit dhe intuitës krijuese me profesionalizmin më të lartë
- D) Sepse kryesisht arriti t'i shpëtojë kthetrave të skematizmit